



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 128

Tiranë – E mërkurë, 22 korrik 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 76/2015, datë 16.7.2015	Për zgjedhjen e deputetes Valentina Leskaj Zëvendëskryetare e Kuvendit..... 6669
Vendim i Kuvendit nr. 77/2015, datë 16.7.2015	Për një shtesë dhe ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 7/2012 “Për miratimin e strukturës dhe organikës të Autoritetit të Konkurrencës”, të ndryshuar..... 6669
Vendim i Kuvendit nr. 78/2015, datë 16.7.2015	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 96/2014 “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”..... 6670
Vendim i Kuvendit nr. 79/2015, datë 16.7.2015	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 104/2014 “Për caktimin e përbërjes së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”, të ndryshuar..... 6671
Vendim i Kuvendit nr. 80/2015, datë 16.7.2015	Për disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 69/2015 “Për caktimin e një anëtari zëvendësues në përbërje të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”..... 6671
Vendim i Kuvendit nr. 81/2015, datë 16.7.2015	Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 5/2015 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar..... 6672
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 633, datë 15.7.2015	Për miratimin e procedurave dhe të kërkesave për dhënien e skemave të ekomenaxhimit dhe auditimit..... 6672
Kërkesë e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 3980, datë 20.7.2015	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken si rezultat i realizimit të projektit “Ndërtimi i linjës së re të ujësjellësit të Durrësit”, në zonën e Adriatikut, Fushë-Milotit dhe Durrësit..... 6697
Kërkesë e ministrit të Energjisë dhe Industrisë nr. 4413/5, datë 15.7.2015	Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga ndërtimi i rrugëve hyrëse dhe urave për zonat Fier, Skrapar dhe Korçë (pjesë e projektit të gazsjellësit “Trans Adriatik”)..... 6698



VENDIM
Nr. 76/2015

PËR ZGJEDHJEN E DEPUTETES
VALENTINA LESKAJ
ZËVENDËSKRYETARE E KUVENDIT

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 2, e 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deputetja Valentina Leskaj zgjidhet në detyrën e Zëvendëskryetares së Kuvendit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 16.7.2015

VENDIM
Nr. 77/2015

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË
VENDIMIN E KUVENDIT NR. 7/2012
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS
DHE ORGANIKËS TË AUTORITETIT
TË KONKURRENCËS”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, me propozimin e Autoritetit të Konkurrencës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI :

I. Lidhja nr. 2 e vendimit të Kuvendit nr. 7/2012, të ndryshuar, ndryshohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 16.7.2015

Lidhja nr. 2

ORGANIKA, KATEGORIZIMI DHE NUMRI I PUNONJËSVE TË
AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

(Struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës janë miraturar sipas vendimit të Kuvendit nr. 7/2012, ndryshuar me vendimin e Kuvendit nr. 68/2014.)

POZICIONI	NUMRI
I. KRYETAR	(1)
II. KOMISIONER	(4)
III. KABINETI	(3)
Drejtor kabinetit	1
Këshilltar	1
Sekretare	1
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	(1)
V. Sektori i Analizës dhe Studimeve	(3)
Përgjegjës sektori	III-a 1
Specialist	III-b 1
Specialist (IT)	III-b 1



VI. DREJTORIA E MBIKËQYRJES DHE HETIMIT TË TREGJEVE			(12)
Drejtor			1
<i>Sektori i Pozitës Dominuese</i>			
Inspektor	III-a		3
<i>Sektori Anti-Kartel</i>			
Inspektor	III-a		4
<i>Sektori i Përqendrimeve</i>			
Inspektor	III-a		4
VII. DREJTORIA JURIDIKE, HETIMIT DHE PROCEDURAVE			(5)
Drejtor			1
Inspektor			4
VIII. DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE INTEGRIMIT EUROPIAN			(8)
Drejtor	II-b		1
<i>Sektori i Përafrimit të legjislacionit dhe procedurat</i>			(3)
Përgjegjës sektori	III-a		1
Specialist	III-b		2
<i>Sektori i Burimeve Njerëzore, Buxhetit, Shërbimeve dhe Dokumentacionit</i>			(4)
Përgjegjës sektori	III-a		1
Specialist buxheti	III-b		1
Specialist (arkiv-dokumentacion)	IV-b		1
Punonjëse pastrimi			1

GJITHSEJ**37 veta**

**VENDIM
Nr. 78/2015**

**PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN E KUVENDIT NR. 96/2014
“PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT TË
POSAÇËM PARLAMENTAR PËR
REFORMËN NË SISTEMIN E
DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës, të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit dhe të pikës V të vendimit të Kuvendit nr. 96/2014, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 96/2014 “Për krijimin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”, bëhet ky ndryshim:

I. Pika III ndryshohet si më poshtë:

“III. Komisioni i Posaçëm përbëhet nga 10 anëtarë, nga të cilët 5 janë përfaqësues të shumicës parlamentare (4 PS dhe 1 LSI) dhe 5 të pakicës parlamentare (4 PD e 1 PR). Emrat e anëtarëve të tij përcaktohen me vendim të Kuvendit.”.

II. Pika VI ndryshohet si më poshtë:

“VI. Komisioni i Posaçëm organizon dhe zhvillon veprimtarinë e tij mbështetur në dispozitat e Rregullores së Kuvendit për funksionimin e komisioneve parlamentare. Përfshijmish, në rastet e mungesës së kuorumit, mbledhja e Komisionit zhvillohet me praninë e njërit prej anëtarëve zëvendësues. Përfshijmish, në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e Kryetarit të Komisionit është vendimtare, duke respektuar në çdo vendimmarrje standardet ndërkombëtare të



transparencës e gjithë-përfshirjes, në konsultim me ekspertizën ndërkombëtare, përfshirë dhe Komisionin e Venecias.”.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 16.7.2015

**VENDIM
Nr. 79/2015**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
E KUVENDIT NR. 104/2014 “PËR
CAKTIMIN E PËRBËRJES SË
KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR PËR REFORMËN NË
SISTEMIN E DREJTËSISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 77, pika 1, të Kushtetutës dhe të nenit 24 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarëve të grupeve parlamentare,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 104/2014 “Për caktimin e përbërjes së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

I. Pika I ndryshohet si më poshtë:

- | | | | |
|-----|-----------------|-----|-----------------|
| 1. | Fatmir Xhafaj | PS | Kryetar |
| 2. | Eduard Halimi | PD | Zëvendëskryetar |
| 3. | Vasilika Hysi | PS | Sekretar |
| 4. | Pandeli Majko | PS | Anëtar |
| 5. | Ulsi Manja | PS | Anëtar |
| 6. | Spartak Braho | LSI | Anëtar |
| 7. | Oerd Bylykbashi | PD | Anëtar |
| 8. | Arben Ristani | PD | Anëtar |
| 9. | Gent Strazimiri | PD | Anëtar |
| 10. | Fatmir Mediu | PR | Anëtar |

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 16.7.2015

**VENDIM
Nr. 80/2015**

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN E
KUVENDIT NR. 69/2015 “PËR
CAKTIMIN E NJË ANËTARI
ZËVENDËSUES NË PËRBËRJE TË
KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR PËR REFORMËN NË
SISTEMIN E DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21, pika 3, dhe 55, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, pas këshillimit me kryetarët e grupeve parlamentare të Partisë Socialiste dhe të Partisë Demokratike,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 69/2015 “Për caktimin e një anëtar zëvendësues në përbërje të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë”, bëhen këto shtesa:

I. Pas pikës I shtohen pikat I/1 dhe I/2 me këtë përmbajtje:

“I/1. Të caktojë si anëtar zëvendësues në përbërje të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë deputetin e Grupit Parlamentar të PS, Vexhi Muçmata.

I/2. Të caktojë si anëtar zëvendësues në përbërje të Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë deputeten e Grupit Parlamentar të PD, Jorida Tabaku.”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miraturar në datën 16.7.2015

**VENDIM
Nr. 81/2015****PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN E KUVENDIT NR. 5/2015
“PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË
KOMISIONEVE TË PËRHERSHME
TË KUVENDIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, neneve 55, pika 1, dhe 21, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë “Lëvizja Socialiste për Integritet” dhe Kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI :**

Në vendimin e Kuvendit nr. 5/2015 “Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

I. Në pikën I, Komisioni për Integritetin Europian, numri “7”, fjala “anëtar”, përbri emrit Bujar Derveni, zëvendësohet me fjalën “sekretar”.

II. Në pikën I, Komisioni për Politikën e Jashtme, numri “3”, fjala “anëtar”, përbri emrit Namik Dokle, zëvendësohet me fjalën “sekretar”.

III. Në pikën I, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, numri “3”, fjala “anëtar”, përbri emrit Anastas Angjeli, zëvendësohet me fjalën “sekretar”.

IV. Në pikën I, Komisioni për Sigurinë Kombëtare, numri “3”, fjala “anëtar”, përbri emrit Pirro Lutaj, zëvendësohet me fjalën “sekretar”.

V. Në pikën I, Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, numri “12”, fjala “anëtar”, përbri emrit Robert Bitri, zëvendësohet me fjalën “sekretar”.

VI. Në pikën I, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, numri “9”, fjala “anëtar”, përbri emrit Vangjel Tavo, zëvendësohet me fjalën “sekretar”.

VII. Në pikën I, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, numri “8”, fjala

“anëtar”, përbri emrit Mimoza Hafizi, zëvendësohet me fjalën “sekretar”.

VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI
Ilir Meta**

Miraturar në datën 16.7.2015

**VENDIM
Nr. 633, datë 15.7.2015****PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE
DHE TË KËRKESAVE PËR DHËNIEN E
SKEMAVE TË EKOMENAXHIMIT DHE
AUDITIMIT***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 56, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**I. QËLLIMI DHE OBJEKTI**

1. Objekti i këtij vendimi është krijimi i një skeme ekomenaxhimi dhe auditimi (SEMA), si instrument menaxhimi për organizatat e biznesit dhe organizata të tjera për të vlerësuar, për të raportuar e për të përmirësuar performancën e tyre mjedisore.

2. Qëllimi i SEMA-s është të promovojë përmirësime të vazhdueshme në performancën mjedisore të organizatave, nëpërmjet krijimit dhe zbatimit të sistemeve të menaxhimit mjedisor, vlerësimin sistematik, objektiv dhe periodik të performancës së këtyre sistemeve, ofrimin e informacionit për performancën mjedisore, një dialog të hapur me publikun dhe palët e tjera të interesuara dhe përfshirjen aktive të punonjësve në organizata e trajnimin e duhur të tyre.

3. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjet nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar; nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e

*Ky vendim synon të bëjë përafrim të pjesshëmme kërkesat e rregullores të Këshillit dhe Parlamentit Evropian nr.1221/2009, datë 25 nëntor 2009, “Mbi pjesëmarrjen vullnetare nga organizatat në një skemë ekomenaxhimi dhe auditimi të komunitetit, EMAS”.



mjedisit”, të ndryshuar, dhe nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar; ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Analizë mjedisore”, një analizë gjithëpërfshirëse fillestare e aspekteve mjedisore, ndikimeve mjedisore dhe performancës mjedisore në lidhje me aktivitetet, produktet ose shërbimet e një organizate.

b) “Aspekt mjedisor domethënës”, një aspekt mjedisor që ka ose mund të ketë një ndikim domethënës mjedisor;

c) “Aspekt mjedisor i drejtpërdrejtë”, një aspekt mjedisor i shoqëruar me aktivitetet, produktet dhe shërbimet e vetë organizatës mbi të cilën ka një kontroll menaxhimi të drejtpërdrejtë;

ç) “Aspekt mjedisor jo i drejtpërdrejtë”, një aspekt mjedisor që mund të vijë si rezultat i ndërveprimit të një organizate me palët e treta, i cili mund të influencohet nga organizata;

d) “Aspekt mjedisor”, një element i aktiviteteve, produkteve ose shërbimeve të një organizate që ka ose mund të ketë një ndikim në mjedis;

dh) “Auditim mjedisor i brendshëm”, një vlerësim sistematik, i dokumentuar, periodik dhe objektiv, i performancës mjedisore të një organizate, sistemit të menaxhimit dhe proceseve të hartuara për të mbrojtur mjedisin;

e) “Auditues”, një individ ose grup individësh që i përkasin vetë organizatës apo një person fizik ose juridik që vepron në emër të organizatës, i cili kryen një vlerësim, në veçanti, të sistemit operativ të menaxhimit mjedisor, duke përcaktuar përputhshmërinë me politikën dhe programin mjedisor të organizatës e duke përfshirë përputhshmërinë me kërkesat e zbatueshme ligjore në lidhje me mjedisin;

ë) “Deklarata mjedisore e përditësuar”, informacioni gjithëpërfshirës ndaj publikut dhe palëve të tjera të interesuara, që përmban përditësime të deklaratave më të fundit të vlefshme, vetëm në lidhje me performancën mjedisore dhe përmbushjen e detyrimeve të zbatueshme ligjore të organizatës, në lidhje me mjedisin, siç përcaktohet në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi.

f) “Deklarata mjedisore”, informacioni gjithëpërfshirës ndaj publikut dhe palëve të tjera të interesuara në lidhje me informacionin e mëposhtëm të organizatës:

i) strukturën dhe aktivitetet;

ii) politikën mjedisore dhe sistemi menaxhimit mjedisor;

iii) aspektet dhe ndikimet mjedisore;

iv) programin, objektivat dhe synimet mjedisore;

v) performancën mjedisore dhe përputhshmërinë me detyrimet e zbatueshme ligjore në lidhje me mjedisin, siç përcaktohet në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi.

g) “Grup”, një grup i organizatave të pavarura që lidhen me njëra-tjetrën nga afërsia gjeografike ose nga aktiviteti i biznesit, që zbatojnë së bashku sistemin e menaxhimit mjedisor;

gj) “Indikatori performancës mjedisore”, një formulim specifik që lejon matjen e performancës mjedisore të një organizate;

h) “Ndikim mjedisor”, çdo ndryshim pozitiv apo negativ në mjedis që shkaktohet plotësisht ose pjesërisht nga aktivitetet, produktet ose shërbimet e një organizate;

i) “Ndryshim thelbësor”, çdo ndryshim në operimin, strukturën, administrimin, proceset, aktivitetet, produktet ose shërbimet e një organizate, që ka ose mund të ketë një ndikim domethënës në sistemin e menaxhimit mjedisor të organizatës, mjedisin dhe shëndetin e njeriut;

j) “Objekti mjedisor”, një qëllim i përgjithshëm mjedisor, i përcaktuar dhe i matshëm në formë sasiore, që rrjedh nga politika mjedisore, të cilin një organizatë ia vendos vetes për ta arritur;

k) “Organi kompetent”, ministria përgjegjëse për mjedisin;

l) “Organizatë e vogël” nënkupton:

i) ndërmarrje të vogla dhe të mesme, sipas legjislacionit në fuqi;

ii) njësitë e qeverisjes vendore që qeverisin më pak se 10 000 banorë ose autoritete të tjera publike që punësojnë më pak se 250 veta dhe kanë një buxhet vjetor që nuk i tejkalon 20 milionë euro, apo një bilanc vjetor që nuk tejkalon 43 milionë euro, duke përfshirë:

- organet e varësisë së organeve qendrore të administratës publike ose organe këshilluese publike në nivel kombëtar, rajonal ose vendor;

- persona fizikë ose juridikë që kryejnë funksione administrative publike sipas ligjit, duke përfshirë detyra specifike, aktivitete ose shërbime në lidhje me mjedisin; dhe

- persona fizikë a juridikë që kanë përgjegjësi ose funksione publike, apo që ofrojnë shërbime publike në lidhje me mjedisin nën kontrollin e një organi



ose personi të referuar në shkronjën “b”;

ll) “Organizate”, një shoqëri tregtare, ndërmarrje e vogël ose e mesme, kompani, korporatë ose bashkimet e tyre, apo një person fizik/juridik publik ose privat;

m) “Organizmi i akreditimit”, një organizëm kombëtar akreditimi, i cili është përgjegjës për akreditimin dhe mbikëqyrjen e verifikuesve mjedisorë;

n) “Performancë mjedisore”, rezultatet e matshme të menaxhimit mjedisor të një organizate;

nj) “Përputhshmëri ligjore”, zbatimi i plotë i kërkesave të zbatueshme ligjore, duke përfshirë kushtet e lejes/lejeve në lidhje me mjedisin;

o) “Politika mjedisore e një organizate”, qëllimet e përgjithshme dhe drejtimi i një organizate në lidhje me performancën e saj mjedisore, siç shprehet zyrtarisht nga menaxhimi i nivelit më të lartë, duke përfshirë përputhshmërinë me të gjitha kërkesat e zbatueshme ligjore në lidhje me mjedisin dhe, gjithashtu, një angazhim për përmirësim të vazhdueshëm të performancës mjedisore. Ajo ofron një kuadër veprimi dhe për përcaktimin e objektivave dhe synimeve mjedisore;

p) “Praktikat më të mira të menaxhimit mjedisor”, mënyra më efektive me të cilën organizatat mund të zbatojnë sistemin e menaxhimit mjedisor në një sektor përkatës dhe që mund të rezultojë në performancën më të mirë mjedisore nën kushte të caktuara ekonomike dhe teknike;

q) “Program mjedisor”, një përshkrim i masave, përgjegjësi dhe mënyrave/mjeteve të ndërmarra ose të parashikuara për të arritur objektivat e synimet mjedisore dhe afatet kohore për arritjen e objektivave synimeve mjedisore;

r) “Regjistrimi korporatës”, një regjistrim i vetëm i të gjitha vendndodhjeve të një organizate me vendndodhje të pozicionuara në një ose më shumë shtete;

rr) “Sistemi menaxhimit mjedisor”, pjesa e përgjithshme e sistemit të menaxhimit, që përfshin strukturën organizative, aktivitetet e planifikimit, përgjegjësitë, praktikat, procedurat, proceset dhe burimet për zhvillimin, zbatimin, arritjen, rishikimin dhe mirëmbajtjen e politikës mjedisore e menaxhimit të aspekteve mjedisore;

s) “Synim mjedisor”, një kërkesë performance e detajuar, që rrjedh nga objektivat mjedisore, e zbatueshme për një organizatë ose pjesë të saj dhe

që ka nevojë të përcaktohet e të përmbushet në mënyrë që të arrihen ato objektiva;

sh) “Vendndodhje”, një vend i veçantë gjeografik nën kontrollin e menaxhimit të një organizate që mbulon aktivitetet, produktet dhe shërbimet, duke përfshirë të gjithë infrastrukturën, pajisjet dhe materialet; një vendndodhje është entiteti më i vogël që konsiderohet për regjistrim;

t) “Verifikim”, procesi i vlerësimit të konformitetit, i kryer nga një verifikues mjedisor, për të vërtetuar analizën mjedisore, politikën mjedisore, sistemin e menaxhimit mjedisor dhe auditimin e brendshëm mjedisor të një organizate dhe nëse zbatimi i tyre i përmbush kërkesat e këtij vendimi;

th) “Verifikues mjedisor”, një organ i vlerësimit të konformitetit, i cili akreditohet për të kryer verifikimin dhe vlefshmërinë, në përputhje me këtë vendim;

u) “Vlefshmëria”, konfirmimi, nga verifikuesi mjedisor, i cili ka kryer verifikimin, që informacioni dhe të dhënat në deklaratën mjedisore dhe në deklaratën e përditësuar mjedisore të një organizate janë të sigurt, të besueshme e të sakta dhe përmbushin kërkesat e këtij vendimi.

II. REGJISTRIMI I ORGANIZATAVE

1. Organizatat që dëshirojnë të regjistrohen për herë të parë duhet të:

a) kryejnë një analizë mjedisore të të gjitha aspekteve mjedisore të organizatës, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën I dhe në pikën A.3.1, të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) kryejnë një auditim të brendshëm në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikën A.5.5, të shtojcës II, dhe të shtojcës III, bashkëlidhur këtij vendimi;

c) përgatisin një deklaratë mjedisore, në përputhje me shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Organizatat duhet të evidentojnë dhe të dokumentojnë që i përmbushin të gjitha kërkesat e zbatueshme ligjore në lidhje me mjedisin.

3. Analiza mjedisore fillestare, sistemi i menaxhimit mjedisor, procedura e auditimit, zbatimi i tyre si dhe deklarata mjedisore duhet të verifikohen e të bëhen të vlefshme nga një verifikues mjedisor i akredituar/licencuar sipas përcaktimit në pikën 8, të kreut IV, të këtij vendimi.



4. Çdo organizatë që i përmbush kërkesat e përcaktuara në pikat e mësipërme të këtij kreu mund të aplikojë për regjistrim.

5. Aplikimi për regjistrim bëhet tek organi kompetent dhe përfshin këto dokumente:

a) Deklaratën mjedisore në formë elektronike dhe të printuar;

b) Deklaratën të nënshkruar nga verifikuesi mjedisor, i cili ka deklaruar të vlefshme deklaraten mjedisore;

c) Një formular të plotësuar, i cili përfshin, të paktën, informacionin minimal të përcaktuar në shtojcën VI, bashkëlidhur këtij vendimi;

ç) Mandatpagesën për tarifën.

6. Kur një organizatë aplikon për regjistrim, organi kompetent e regjistron organizatën dhe e pajis me numër regjistrimi, nëse përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Organi kompetent ka marrë aplikimin për regjistrim, i cili përfshin të gjithë dokumentacionin e referuar në pikën 5, të këtij vendimi;

b) Organi kompetent ka kontrolluar që verifikimi dhe vlefshmëria janë kryer në përputhje me parashikimet nga pika 13 deri në pikën 23, të kreut IV, të këtij vendimi;

c) Nuk ka ankesa në lidhje me të nga palët e interesuara ose ankesat janë zgjidhur në mënyrë pozitive;

ç) Organi kompetent është i kënaqur, bazuar në evidencat që ka marrë, që organizata i përmbush të gjitha kërkesat e kësaj rregulloreje;

d) Është kryer pagesa e tarifës së regjistrimit.

7. Organi kompetent informon organizatën që është regjistruar dhe e pajis atë me numrin e saj të regjistrimit, si dhe me logon SEMA, sipas shtojcës V, bashkëlidhur këtij vendimi.

8. Nëse një organizatë nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në pikën 6, të këtij vendimi, organi kompetent refuzon regjistrimin e asaj organizate, duke dhënë arsye të argumentuara.

9. Organi kompetent konsultohet me palët, duke përfshirë edhe organizatën, për marrjen e vendimit për refuzimin e regjistrimit.

10. Në përfundim të procedurave të përcaktuara në këtë kre, organi kompetent merr një prej vendimeve të mëposhtme:

a) Regjistron organizatën dhe e pajis me logon SEMA pasi ka marrë në konsideratë vëzhgimet nga palët e interesuara, duke përfshirë autoritetet kompetente të kontrollit dhe organet përfaqësuese

të organizatës;

b) refuzon regjistrimin, pezullon ose fshin nga regjistri organizatën.

11. Kundër vendimit të organit kompetent, organizata ka të drejtën e ankimit tek titullari i organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi.

12. Organi kompetent krijon Regjistrin Kombëtar të SEMA-s për organizatat e regjistruara, në të cilin përfshihen kopje të deklarave mjedisore ose kopje të deklarave mjedisore të përditësuara.

13. Regjistri përditësohet çdo muaj dhe është publikisht i disponueshëm në faqen zyrtare të internetit të organit kompetent.

14. Metodika e vendosjes së numrit të regjistrimit, modeli i regjistrit dhe rregullat e administrimit të tij miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për mjedisin.

III. DËTYRIMET E ORGANIZATAVE TË REGJISTRUARA

1. Një organizatë e regjistruar SEMA, të paktën çdo tre vjet nga data e regjistrimit, rinovon regjistrimin, pasi:

a) të ketë të verifikuar sistemin e plotë të menaxhimit mjedisor dhe programin e auditimit e zbatimin e tyre;

b) të përgatitë deklaraten mjedisore në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe ta ketë atë të vlefshme nga një verifikues mjedisor;

c) t'i dërgojë organit kompetent deklaraten e vlefshme mjedisore;

ç) t'i dërgojë organit kompetent një formular të plotësuar, që përfshin të paktën informacionin minimal të përcaktuar në shtojcën VI, bashkëlidhur këtij vendimi;

d) të paguajë tek organi kompetent një tarifë për rinovimin e regjistrimit.

2. Gjatë periudhave të ndërmjetme 3-vjeçare, një organizatë e regjistruar përditëson çdo vit deklaraten mjedisore pasi:

a) në përputhje me programin e auditimit, kryen një auditim të brendshëm për performacën e saj mjedisore dhe përmbushjen e kërkesave të zbatueshme ligjore në lidhje me mjedisin, sipas shtojcës III, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) përgatit deklaraten mjedisore të përditësuar, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi, e cila miratohet nga një verifikues mjedisor, dhe ia dërgon organit



kompetent deklaratën e vlefshme mjedisore;

c) i dërgon organit kompetent një formular të plotësuar, i cili përfshin të paktën informacionin minimal të përcaktuar në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Organizatat e regjistruara bëjnë të disponueshme për publikun deklaratat e tyre mjedisore dhe deklaratat e përditësuara mjedisore, brenda një muaji nga data e regjistrimit dhe pas një muaji pasi është përfunduar rinovimi i regjistrimit, nëpërmjet publikimit të tyre në faqen zyrtare të organizatës.

4. Organizatat e regjistruara përcaktojnë mënyrën se si ato ofrojnë akses për publikun në formularin e përcaktuar në shtojcën VI, bashkëlidhur këtij vendimi.

5. Organi kompetent, me kërkesë të organizatës së vogël, shtrin periudhën trevjeçare të rinovimit të regjistrimit deri në katër vjet, si edhe periudhat e ndërmjetme të përditësimit deri në dy vjet, pasi verifikuesi mjedisor ka verifikuar që janë përmbushur kushtet e mëposhtme:

a) Nuk ka të pranishëm asnjë rrezik domethënës mjedisor;

b) Organizata nuk ka planifikuar asnjë ndryshim thelbësor, siç është përcaktuar në pikën 9, të këtij kreu.

c) Nuk ka asnjë problem domethënës mjedisor vendor ndaj të cilit kontribuon organizata.

6. Për të dorëzuar kërkesën e përmendur në pikën 5, organizata mund të përdorë formularin e përcaktuar në shtojcën VI, bashkëlidhur këtij vendimi.

7. Organi kompetent e refuzon kërkesën e organizatës nëse nuk përmbushen kushtet e përcaktuara në pikën 5, duke arsyetuar qëndrimin.

8. Për të inkurajuar funksionimin eficient të tregut dhe ngritjen e nivelit të konkurrencës, rinovimi i regjistrimit për këto organizata do të jetë në përputhje me legjislacionin për ndihmën shtetërore.

9. Kur një organizatë e regjistruar planifikon të bëjë ndryshime, ajo kryen një analizë mjedisore të këtyre ndryshimeve, duke përfshirë aspektet dhe ndikimet e tyre mjedisore.

10. Në vazhdim të analizës mjedisore të ndryshimeve, organizata duhet të përditësojë analizën mjedisore fillestare, të modifikojë politikën mjedisore, programin mjedisor dhe sistemin e menaxhimit mjedisor, si dhe të

rishikojë e përditësojë të gjithë deklaratën mjedisore, në përputhje me rrethanat.

11. Në zbatim të pikës 10, të këtij vendimi, të gjitha dokumentet e modifikuara e të përditësuara duhet të verifikohen dhe të miratohen të vlefshme, brenda 6 (gjashtë) muajve, nga verifikuesi mjedisor.

12. Pas miratimit të dokumenteve të mësipërme nga verifikuesi, organizata dorëzon ndryshimet tek organi kompetent, duke përdorur formën e përcaktuar në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe i bën ndryshimet të disponueshme për publikun në faqen e saj elektronike.

13. Një organizatë e regjistruar krijon një program auditimi që siguron, për një periudhë kohe të caktuar, pa tejkaluar 3 (tre) vjet ose 4 (katër) vjet, nëse është zbatuar parashikimi në pikat 5, 6 dhe 7 të këtij kreu, që të gjitha aktivitetet në organizatë i nënshtrohen auditimit të brendshëm, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi.

14. Auditimi kryhet nga audituesit, të cilët zotërojnë, individualisht ose bashkërisht, kompetencën e nevojshme për të kryer këto detyra, janë të pavarur nga aktivitetet që ata auditojnë dhe japin një gjykim objektiv.

15. Programi auditimit mjedisor i organizatës duhet të përcaktojë objektivat e çdo auditimi ose cikli auditimesh, duke përfshirë frekuencën e auditimit për çdo aktivitet.

16. Audituesit përgatitin një raport auditimi në fund të çdo auditimi ose cikli auditimesh dhe i komunikojnë organizatës gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe rekomandime për përmirësimin e sistemit të menaxhimit mjedisor.

17. Në vazhdim të procesit të auditimit, organizata duhet të përgatitë dhe të zbatojë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

18. Organizata duhet të ngrejë mekanizmat e duhur për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

19. Logoja SEMA, e përcaktuar në shtojcën V, bashkëlidhur këtij vendimi, përdoret nga organizatat e regjistruara dhe vetëm gjatë kohës kur regjistrimi i tyre është i vlefshëm. Ajo mban gjithmonë numrin e regjistrimit të organizatës.

20. Logoja SEMA përdoret vetëm në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën V, bashkëlidhur këtij vendimi.



21. Në rastin kur një organizatë zgjedh të mos përfshijë të gjitha vendndodhjet e saj në regjistrimin e korporatës, ajo duhet të sigurojë që, në komunikimet e saj me publikun dhe në përdorimin e logos SEMA, të jetë e qartë se cilat vendndodhje mbulohen nga regjistrimi.

22. Logoja SEMA nuk përdoret:

a) mbi produkte ose në paketimet e tyre;
b) së bashku me deklaratat krahasuese në lidhje me aktivitete ose shërbime të tjera, apo në një mënyrë që mund të krijojë konfuzion me etiketat mjedisore të produktit.

23. Çdo informacion mjedisor i publikuar nga një organizatë e regjistruar mund të mbajë logon SEMA, me kusht që t'i referohet deklaratës më të fundit mjedisore ose deklaratës mjedisore të përditësuar të organizatës nga e cila është hartuar dhe që është bërë e vlefshme nga një verifikues mjedisor, që është:

- a) e saktë;
- b) e verifikuar dhe e verifikueshme;
- c) përkatëse dhe e përdorur në një kontekst ose vendosje të duhur;
- ç) përfaqësuese e performancës së përgjithshme mjedisore të organizatës;
- d) nuk ka mundësi të rezultojë në keqinterpretime; dhe
- dh) e rëndësishme në lidhje me ndikimin e përgjithshëm të mjedisit.

24. Nëse një organ kompetent merr një raport mbikëqyrjeje, me shkrim, nga një organizëm akreditimi, i cili evidenton që aktivitetet e verifikuesit mjedisor nuk janë kryer në përputhje me kërkesat e këtij vendimi për organizatën, ai refuzon regjistrimin e asaj organizate. Organi kompetent njofton organizatën të dorëzojë një aplikim të ri për regjistrim.

25. Nëse Inspektorati Shtetëror për Mjedisin konstaton shkelje, nga organizata, të kërkesave të zbatueshme ligjore në lidhje me mjedisin, njofton brenda 3 (tre) ditëve organin kompetent, i cili pezullon nga regjistri organizatën deri në marrjen e vendimit përfundimtar nëse organizatës do t'i hiqet logoja SEMA dhe do të fshihet nga regjistri. Vendimi për pezullim, fshirje nga regjistri dhe heqja e logos SEMA bëhen me urdhër të titullarit të organit kompetent.

26. Në rastin kur organi kompetent vendos të pezullojë ose të fshijë një regjistrim, ai duhet të marrë në konsideratë, të paktën, sa më poshtë:

a) ndikimin mjedisor që vjen nga mos-përputhshmëria e organizatës me kërkesat e këtij vendimi;

b) parashikueshmërinë e mospërputhshmërisë nga ana e organizatës me kërkesat e këtij vendimi ose me rrethanat që çojnë në të;

c) raste të mëparshme të mospërputhshmërisë me kërkesat e këtij vendimi nga organizata, dhe

ç) rrethanat specifike të organizatës.

27. Organi kompetent jep arsyet për çdo masë të marrë. Ndaj vendimit të organit kompetent bëhet ankim sipas legjislacionit në fuqi.

28. Organi kompetent i ofron organizatës informacionin e duhur në lidhje me konsultimet me palët e interesuara.

29. Vendimi i pezullimit të një organizate nga regjistri revokohet nëse organi kompetent ka marrë informacion të mjaftueshëm që organizata kryen veprimtarinë e saj në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

IV. VERIFIKUESI MJEDISOR

1. Verifikuesi mjedisor vlerëson nëse rishikimi mjedisor, politika mjedisore, sistemi i menaxhimit, procedurat e auditimit të një organizate dhe zbatimi i tyre përputhen me kërkesat e këtij vendimi.

2. Verifikuesi mjedisor verifikon, sa më poshtë:

a) përputhshmërinë e një organizate me të gjitha kërkesat e këtij vendimi në lidhje me analizën mjedisore fillestare, sistemin e menaxhimit mjedisor, auditimin mjedisor dhe rezultatet e tij dhe deklaratën mjedisore ose deklaratën mjedisore të përditësuar;

b) përputhshmërinë e organizatës me kërkesat ligjore në fuqi në fushën e mjedisit;

c) përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore të organizatës;

ç) sigurinë, besueshmërinë e saktësinë e të dhënave dhe informacionit në dokumentacionin e mëposhtëm:

i) deklaratën mjedisore;

ii) deklaratën mjedisore të përditësuar;

iii.) çdo informacion mjedisor që duhet të bëhet i vlefshëm.

3. Verifikuesi mjedisor, në veçanti, duhet të verifikojë përshtatshmërinë e analizës mjedisore fillestare ose të auditimit apo të procedurave të tjera të kryera nga organizata, duke shmangur mbivendosjen e procedurave.



4. Verifikuesi mjedisor duhet të verifikojë nëse rezultatet e auditimit të brendshëm janë të besueshme. Kur është e nevojshme, për këtë qëllim, ai kryen verifikime dhe inspektime të palajmëruara.

5. Gjatë fazës së verifikimit për përgatitjen e regjistrimit të një organizate, verifikuesi mjedisor kontrollon që organizata përmbush, të paktën, kriteret e mëposhtme:

a) ka ngritur një sistem menaxhimi mjedisor plotësisht operativ, në përputhje me shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) ka krijuar një program auditimi të planifikuar në përputhje me shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi;

c) është përfunduar analiza e menaxhimit, referuar në pjesën A, të shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi; dhe

ç) në përputhje me shtojcën IV, bashkë-lidhur këtij vendimi, është përgatitur deklarata mjedisore.

6. Për qëllime të verifikimit për rinovimin e regjistrimit, verifikuesi mjedisor kontrollon që nga organizata janë përmbushur kërkesat e mëposhtme:

a) ka një sistem menaxhimi mjedisor operativ në përputhje me shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) ka një program të planifikuar operativ auditimi, me të paktën një cikël auditimi të përfunduar, në përputhje me shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi;

c) ka përfunduar një analizë menaxhimi; dhe

ç) ka përgatitur deklaratën mjedisore në përputhje me shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi.

7. Për qëllimet e verifikimit për rinovimin e regjistrimit referuar në pikat 1, 2, 3 dhe 4, të kreut III, të këtij vendimi, verifikuesi mjedisor duhet të kontrollojë që organizata përmbush, të paktën, kërkesat e mëposhtme:

a) ka kryer një auditim të brendshëm të performancës mjedisore dhe përputhshmërisë me kërkesat e zbatueshme ligjore në lidhje me mjedisin në përputhje me shtojcën III bashkëlidhur këtij vendim;

b) vërteton përputhshmëri të vazhdueshme me kërkesat e zbatueshme ligjore në lidhje me mjedisin dhe përmirësim të vazhdueshëm të performancës së saj mjedisore; dhe

c) ka përgatitur deklaratën mjedisore të përditësuar në përputhje me shtojcën IV, bashkëlidhur

këtij vendimi.

8. Verifikuesi mjedisor akreditohet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, sipas legjislacionit në fuqi dhe kërkesave specifike të këtij vendimi. Në aplikimin për akreditim cilësohen qartë aktivitete industriale apo të tjera që janë objekt i akreditimit, sipas kategorizimit NACE. Verifikuesi mjedisor mund të akreditohet edhe pranë organeve kompetente të akreditimit dhe licencimit të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, sipas përcaktimeve në rregulloren e Këshillit dhe Parlamentit Evropian nr. 1221/2009, datë 25 nëntor 2009, “Mbi pjesëmarrjen vullnetare nga organizatat në një skemë ekomenaxhimi dhe auditimi të komunitetit EMAS”.

9. Verifikuesi mjedisor paraqet tek Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit evidencat në lidhje me aftësinë e tij, duke përfshirë njohuritë, eksperiencën përkatëse dhe kapacitetet teknike që kanë lidhje me:

a) fushën që mbulon ky vendim;

b) funksionimin e përgjithshëm të sistemeve të menaxhimit mjedisor;

c) aspektet dhe ndikimet mjedisore, duke përfshirë dimensionin mjedisor të zhvillimit të qëndrueshëm;

ç) funksionimin e përgjithshëm të aktivitetit subjekt verifikimi dhe miratimin e vlefshmërisë në mënyrë që të vlerësohet përshtatshmëria e sistemit të menaxhimit, në lidhje me ndërveprimin e organizatës dhe produkteve, shërbimeve dhe operacioneve të saj me mjedisin, duke përfshirë, të paktën, sa më poshtë:

i) teknologjitë e përdorura nga organizata;

ii) terminologjinë dhe mjetet e përdorura në aktivitete;

iii) aktivitetet operative dhe karakteristikat e ndërveprimit të tyre me mjedisin;

iv) metodologjitë për vlerësimin e aspekteve domethënëse mjedisore;

v) teknologji të për kontrollin e ndotjes dhe të zvogëlimit të saj;

d) kërkesat dhe metodologjinë e auditimit mjedisor, duke përfshirë aftësinë për të ndër-marrë auditime verifikimi efektive të sistemit të menaxhimit mjedisor, identifikimin e gjetjeve të duhura të auditimit dhe konkluzionet, si dhe përgatitjen e prezantimit e raporteve të auditimeve, në formë të shkruar, për të ofruar të dhëna



të qarta të auditimit të verifikimit;

dh) auditimin e informacionit, deklaratën mjedisore dhe deklaratën mjedisore të përditësuar në lidhje me menaxhimin e të dhënave, ruajtjen dhe përpunimin e të tyre, prezantimin e të dhënave në format të shkruar dhe grafik për të vlerësuar gabimet potenciale të të dhënave, përdorimin e supozimeve dhe llogaritjeve;

e) dimensionin mjedisor të produkteve dhe shërbimeve, duke përfshirë aspektet mjedisore dhe performancën mjedisore, si dhe integritetin e të dhënave të parashikuara për vendimmarrje mjedisore.

10. Verifikuesi mjedisor duhet të vërtetojë zhvillim profesional të vazhdueshëm në fushën e kompetencës, të përcaktuar në pikën 9, të këtij vendimi.

11. Verifikuesi mjedisor duhet të jetë një palë e tretë, e jashtme, i pavarur, në veçanti në lidhje me audituesin ose konsulentin e organizatës, i paanshëm dhe objektiv në kryerjen e aktiviteteve të tij.

12. Verifikuesi mjedisor siguron se nuk ka konflikt interesi tregtar, financiar që mund të ndikojë në gjykimin e tij në lidhje me veprimtaritë për të cilat ofron shërbimin e verifikimit.

13. Verifikuesi mjedisor kryen veprimtarinë e tij brenda fushëveprimit për të cilën është akredituar dhe në bazë të një kontrate të shkruar me organizatën, e cila duhet të përmbajë, të paktën,:

a) qëllimin e veprimtarisë;

b) synimet që kërkon të arrijë organizata për t'i mundësuar verifikuesit mjedisor që të veprojë në mënyrë profesionale të pavarur; dhe

c) angazhimin e organizatës për të siguruar bashkëpunimin e nevojshëm.

14. Verifikuesi mjedisor siguron që veprimtaritë e një organizate janë të përcaktuara qartë. Deklarata mjedisore duhet të specifikojë qartë pjesët e ndryshme të organizatës që janë subjekt i verifikimit dhe vlefshmërisë.

15. Si pjesë e aktiviteteve të verifikimit dhe miratimit të vlefshmërisë, verifikuesi mjedisor duhet të ekzaminojë dokumentacionin, të kryejë kontrole të palajmëruara dhe të kryejë intervista me personelin.

16. Përpara se verifikuesi mjedisor të kryejë kontrollin, organizata i vë në dispozicion atij informacion rreth organizatës dhe aktiviteteve të saj, politikës dhe programit mjedisor, përshkrimin e sistemit të menaxhimit mjedisor në operim në organizatë, detajet e analizës mjedisore ose auditimit të kryer, raportin e asaj analize ose auditimit dhe çdo veprim korrigjues të marrë më pas, si dhe draftin e deklaratës mjedisore ose deklaratën mjedisore të përditësuar.

17. Verifikuesi mjedisor përgatit një raport, me shkrim, për organizatën, për rezultatet e verifikimit, i cili specifikon:

a) të gjitha çështjet që kanë lidhje me aktivitetet e kryera nga verifikuesi mjedisor;

b) një përshkrim të përputhshmërisë me kërkesat e këtij vendimi;

c) krahasimet me deklaratat e mëparshme mjedisore dhe vlerësimin e performancës mjedisore, si edhe vlerësimin e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës mjedisore të organizatës;

ç) nëse është i zbatueshëm, të metat në analizën mjedisore, metodën e auditimit, sistemin e menaxhimit mjedisor ose çdo proces tjetër përkatës.

18. Në rast të mospërputhshmërisë me kërkesat e këtij vendimi, raporti duhet të specifikojë gjetjet dhe konkluzionet e mospërputhshmërisë nga organizata dhe argumentet teknike e ligjore mbi të cilat bazohen këto gjetje dhe konkluzione.

19. Pas verifikimit, verifikuesi mjedisor duhet të miratojë të vlefshme deklaratën mjedisore dhe deklaratën mjedisore të përditësuar të organizatës, si dhe të konfirmojë se i përmbush kërkesat e parashikuara në këtë vendim dhe që rezultatet e verifikimit e të miratimit konfirmojnë që:

a) informacioni e të dhënat në deklaratën mjedisore dhe deklaratën mjedisore të përditësuar të organizatës janë të besueshme e të sakta dhe përmbushin kërkesat e këtij vendimi;

b) nuk ka asnjë argumentim që organizata nuk i përmbush kërkesat e zbatueshme ligjore në lidhje me mjedisin.

20. Pas miratimit të vlefshmërisë, verifikuesi mjedisor duhet të lëshojë një deklaratë të nënshkruar, siç referohet në shtojcën VII, bashkëlidhur këtij vendimi, duke deklaruar që verifikimi dhe miratimi i vlefshmërisë është kryer në përputhje me këtë vendim.



21. Verifikuesi mjedisor, gjatë kryerjes së aktiviteteve të verifikimit dhe vlefshmërisë, merr në konsideratë karakteristikat specifike të organizatave të vogla, duke përfshirë, sa më poshtë:

- a) linjat e shkurtra të raportimit;
- b) një staf multifunksional;
- c) trajnime në punë;
- ç) aftësinë për t'u përshtatur shpejt ndaj ndryshimit; dhe
- d) dokumentacion të kufizuar të procedurave.

22. Verifikuesi mjedisor kryen verifikim ose miratim vlefshmërie në mënyrë të tillë që nuk vendos ngarkesa të panevojshme mbi organizatat e vogla.

23. Verifikuesi mjedisor merr në konsideratë të dhëna objektive që një sistem është efektiv, duke përfshirë ekzistencën e procedurave brenda organizatës, të cilat janë në proporcion me madhësinë dhe kompleksitetin e operacionit, natyrën e ndikimeve mjedisore shoqëruese dhe kompetencën e operatorëve.

V. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

1. Vlerat e tarifave të aplikimit për regjistrim dhe për rinovimin e regjistrimit miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe ministrit përgjegjës për financat. Tarifat derdhen në buxhetin e shtetit.

2. Kostot e auditimit dhe verifikimit të vlefshmërisë nga ana e verifikuesit të akredituar, si edhe çdo kosto tjetër për pajisjen me logon SEMA përballohen nga organizata.

3. Ngarkohen ministria përgjegjëse për mjedisin, ministria përgjegjëse për ekonominë dhe autoriteti përgjegjës për akreditimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet juridike nga 1 janari 2017.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA I ANALIZA MJEDISORE

Analiza mjedisore duhet të përfshijë fushat e mëposhtme:

1. Identifikimin e kërkesave të zbatueshme ligjore në lidhje me mjedisin

Përveç krijimit të një liste me kërkesat e zbatueshme ligjore, organizata duhet të tregojë gjithashtu se si mund të ofrohet evidencë që ajo

është në përputhje me kërkesat e ndryshme.

2. Identifikimin e të gjitha aspekteve mjedisore të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, që kanë një ndikim domethënës në mjedis, të cilësuar dhe sasiuara, si të jetë e përshtatshme, dhe përpilimin e një regjistri për ato që janë identifikuar si domethënëse

Një organizatë, në vlerësimin e rëndësisë të aspekteve mjedisore, duhet të marrë në konsideratë çështjet e mëposhtme:

- i) potencialin për të shkaktuar dëm mjedisor;
- ii) brishtësinë e mjedisit lokal, rajonal dhe global;
- iii) madhësinë, numrin, frekuencën dhe mundësinë e rikthimit të aspektit ose ndikimit;
- iv) ekzistencën dhe kërkesat e legjislacionit përkatës mjedisor;
- v) rëndësinë e aktorëve të interesuar dhe punonjësve të organizatës;

a) Aspektet mjedisore të drejtpërdrejta

Aspektet mjedisore të drejtpërdrejta janë të shoqëruara me aktivitetet, produktet dhe shërbimet e vetë organizatës mbi të cilën ajo ka kontroll menaxhimi të drejtpërdrejtë.

Të gjitha organizatat duhet të marrin në konsideratë aspektet e drejtpërdrejta të operacioneve të tyre.

Aspektet mjedisore të drejtpërdrejta lidhen, por nuk janë të kufizuara me:

- i) kërkesat ligjore dhe kufizimet e lejes;
- ii) emetimet në ajër;
- iii) çlirimet në ujë;
- iv) prodhimin, riciklimin, ripërdorimin, transportimin dhe asgjësimin e mbeturinave të ngurta dhe të tjera, veçanërisht mbetjet e rrezikshme;
- v) përdorimin dhe ndotjen e tokës;
- vi) përdorimin e burimeve natyrore dhe materialet e papërpunuara, duke përfshirë energjinë;
- vii) përdorimin e shtesave dhe ndihmësve si edhe mallrat gjysmë të prodhuara;
- viii) çështjet lokale (zhurmën, vibracionin, erën, pluhurin, paraqitjen vizive etj.);
- ix) çështjet e transportit si për mallrat, ashtu dhe për shërbimet;
- x) rrezikun e aksidenteve mjedisore dhe ndikimet që vijnë ose që kanë gjasa të vijnë, si rrjedhojë e incidenteve, aksidenteve dhe situatave emergjente potenciale;
- xi) efektet në biodiversitet.



b) Aspektet mjedisore jo të drejtpërdrejta

Aspektet mjedisore jo të drejtpërdrejta mund të vijnë si rezultat i ndërveprimit të një organizate me palë të treta, të cilat, deri në një masë të arsyeshme, mund të influencohen nga organizata që kërkon regjistrimin në SEMA.

Për organizata joindustriale, siç janë autoritetet lokale ose institucione financiare, është thelbësore që, gjithashtu, edhe ato të marrin në konsideratë aspektet mjedisore të shoqëruara me biznesin e tyre kryesor. Një inventar i kufizuar në aspektet mjedisore të vendndodhjes ose mjeteve të një organizate është i pamjaftueshëm.

Këto përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

i) çështjet në lidhje me ciklin jetësor të produktit (projektimin, zhvillimin, paketimin, transportimin, përdorimin dhe rikuperimin/asgjësimin e mbeturinave);

ii) investimet në kapital, dhënien e kredive dhe shërbimet e sigurimeve;

iii) tregjet e reja;

iv) zgjedhjen dhe përbërjen e shërbimeve (p.sh., transporti ose tregtia e furnizimit të ushqimit);

v) vendimet administrative dhe planifikuese;

vi) përbërjen e gamës së produkteve;

vii) performancën dhe praktikat mjedisore të kontraktorëve, nënkontraktorëve dhe furnizuesve.

Organizatat duhet të jenë në gjendje të vërtetojnë që janë identifikuar aspektet domethënëse mjedisore të shoqëruara me procedurat e prokurimeve të tyre dhe që këto ndikime domethënëse mjedisore të shoqëruara me këto aspekte janë adresuar brenda sistemit të menaxhimit. Organizata duhet të përpiqet të sigurojë që furnizuesit dhe ata që veprojnë për llogari të organizatës përputhen me politikën mjedisore të saj brenda kompetencave të aktiviteteve të kryera për kontratën.

Në rastin e këtyre aspekteve mjedisore jo të drejtpërdrejta, një organizatë duhet të marrë në konsideratë se sa shumë ndikim mund të kenë mbi këto aspekte dhe çfarë masash mund të merren për të reduktuar ndikimin mjedisor.

3. Përshkrimin e kriterëve për të vlerësuar rëndësinë e ndikimit mjedisor;

Një organizatë duhet të përcaktojë kriteret për vlerësimin e rëndësisë së aspekteve mjedisore të aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të saj, në mënyrë që të përcaktojë se cilat kanë një ndikim domethënës mjedisor.

Kriteret e hartuara nga një organizatë duhet të marrin në konsideratë legjislacionin e komunitetit dhe duhet të jenë gjithëpërfshirëse, të afta për kontroll të pavarur, të riprodhueshme dhe të jenë bërë publikisht të disponueshme.

Konsideratat në krijimin e kriterëve të vlerësimit për rëndësinë e aspekteve mjedisore të një organizate mund të përfshijnë, por pa u kufizuar në to:

a) informacion për kushtet e mjedisit për të identifikuar aktivitetet, produktet dhe shërbimet e organizatës, që mund të kenë një ndikim mjedisor;

b) të dhënat ekzistuese të organizatës për inputet e materialit dhe energjisë, shkarkimeve, mbeturinave dhe emetimet në termat e rrezikut;

c) pikëpamjet e palëve të interesuara;

ç) aktivitetet mjedisore të organizatës që janë sipas rregullave;

d) aktivitetet e prokurimit;

dh) projektimin, zhvillimin, prodhimin, shpërndarjen, shërbimin, përdorimin, ripërdorimin, riciklimin dhe asgjësimin e produkteve të organizatës;

e) ato aktivitete të organizatës me kostot mjedisore më domethënëse dhe përfitimet mjedisore.

Në vlerësimin e rëndësisë të ndikimeve mjedisore të aktiviteteve të një organizate, organizata nuk duhet të mendojë vetëm për kushtet normale të operimit, por edhe për kushtet e ndezjes / fillimit dhe fikjes/mbylljes, si dhe për kushtet e parashikuara të konsideruara emergjente. Duhet të merren në konsideratë aktivitetet në të shkuarën, në të tashmen dhe ato të planifikuara.

4. Ekzaminimin e të gjitha praktikave të procedurave ekzistuese të menaxhimit mjedisor

5. Vlerësimin e reagimit/feedback-un nga hetimi i incidenteve të mëparshme.

SHTOJCA II

KËRKESAT E SISTEMIT TË MENAXHIMIT MJEDISOR DHE ÇËSHTJET PLOTËSUESE QË DUHET TË ADRESOHEN NGA ORGANIZATAT QË ZBATOJNË SKEMËN E EKOMENAXHIMIT DHE AUDITIMIT (SEMA)

Kërkesat e sistemit të menaxhimit mjedisor, sipas SEMA-s, janë ato të përcaktuara në seksionin 4, të standardit EN ISO 14001:2004. Këto kërkesa



janë riprodhuar në kolonën e majtë të tabelës së mëposhtme, e cila përbën pjesën A, të kësaj shtojce.

Për më tepër, organizatave të regjistruara u kërkohet të adresojnë një numër çështjesh plotësuese që kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me

një numër elementesh në seksionin 4, të standardit EN ISO 14001:2004. Këto kërkesa plotësuese janë renditur në kolonën e djathtë të tabelës së mëposhtme, e cila përbën pjesën B, të kësaj shtojce.

PJESA A Kërkesat e sistemit të menaxhimit mjedisor sipas EN ISO 14001:2004	PJESA B Çështjet plotësuese që duhet të adresohen nga organizatat që zbatojnë SEMA
Organizatat që marrin pjesë në skemën e ekuimenaxhimit dhe auditimit (SEMA) duhet të zbatojnë kërkesat e EN ISO 14001:2004, të cilat janë përshkruar në seksionin 4, të standardit evropian dhe janë riprodhuar plotësisht më poshtë: A. Kërkesat e sistemit të menaxhimit mjedisor A.1. Kërkesat e përgjithshme Organizata duhet të krijojë, të dokumentojë, të zbatojë, të mbajë dhe të përmirësojë në vazhdimësi një sistem menaxhimi mjedisor, në përputhje me kërkesat e këtij standardi ndërkombëtar dhe të përcaktojë se si ajo i përmbush këto kërkesa. Organizata duhet të përcaktojë dhe të dokumentojë qëllimin/fushëveprimin e sistemit të saj të menaxhimit mjedisor A.2. Politika mjedisore Menaxhimi i nivelit më të lartë duhet të përcaktojë politikën mjedisore të organizatës dhe të sigurojë që brenda qëllimit të përcaktuar të sistemit të saj të menaxhimit mjedisor, ajo: a) është e përshtatshme me natyrën, shkallën dhe ndikimet mjedisore të aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të saj; b) përfshin një angazhim për përmirësim të vazhdueshëm dhe parandalim të ndotjes; c) përfshin një angazhim për të përmbushur kërkesat e zbatueshme ligjore dhe me kërkesa të tjera të cilat kanë lidhje me aspektet mjedisore; ç) parashikon një kuadër për përcaktimin dhe rishikimin e të objektivave dhe synimeve mjedisore; d) është e dokumentuar, e zbatuar dhe e mirëmbajtur; - dh) i është komunikuar të gjithë personave që punojnë për llogari të organizatës; dhe e) është e disponueshme për publikun. A.3. Planifikimi A.3.1 Aspektet mjedisore Organizata duhet të krijojë, zbatojë dhe të mbajë një procedurë (procedurat)	B.1. Analiza mjedisore Organizatat duhet të kryejnë një analizë mjedisore fillestare, siç është përcaktuar në shtojcën 1, në mënyrë që të identifikojnë aspektet e tyre mjedisore dhe kërkesat e zbatueshme ligjore në lidhje me mjedisin. B.2. Përputhshmëria ligjore Organizatat që dëshirojnë të regjistrohen në SEMA duhet të jenë gjendje të vërtetojnë që: a) kanë identifikuar dhe i dinë implikimet ndaj organizatës për të gjitha kërkesat e zbatueshme ligjore në lidhje me mjedisin, të identifikuara gjatë analizës mjedisore në përputhje me shtojcën I; b) parashikojnë për përputhshmëri ligjore me legjislacionin mjedisor, duke përfshirë lejet dhe kufizimet e lejeve; dhe c) kanë procedurë operative që mundësojnë organizatën të përmbushë këto kërkesa në vazhdimësi. B.3 Performanca mjedisore 1) Organizatat duhet të jenë në gjendje të vërtetojnë që sistemi i menaxhimit dhe procedurat e auditimit adresojnë performancën aktuale mjedisore të organizatës në lidhje me aspektet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të identifikuara në analizën mjedisore, sipas shtojcës 1. 2) Performanca mjedisore e organizatës kundrejt objektivave dhe synimeve të saj duhet të vlerësohet si pjesë e procesit të analizës së menaxhimit. Organizata duhet, gjithashtu, të angazhohet vetë në përmirësim të vazhdueshëm të performancës së saj mjedisore. Duke vepruar në këtë mënyrë, organizata mund të bazojë veprimet e saj në programet mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale. 3) Mënyrat për të arritur objektivat dhe synimet nuk mund të jenë objektiva mjedisore. Nëse organizata përbëhet nga një a më shumë vendndodhje, në secilën nga vendndodhjet ku



PJESA A Kërkesat e sistemit të menaxhimit mjedisor sipas EN ISO 14001:2004	PJESA B Çështjet plotësuese që duhet të adresohen nga organizatat që zbatojnë SEMA
a) për të identifikuar aspektet mjedisore të aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të saj brenda qëllimit të përcaktuar të sistemit të menaxhimit mjedisor që ajo mund të kontrollojë dhe ato që ajo mund të influencojë, duke marrë në konsideratë zhvillimet e planifikuara ose të reja, apo aktivitetet, produktet dhe shërbimet e reja ose të modifikuara; dhe b) të përcaktojë ato aspekte që kanë ose kanë gjasa të kenë një ndikim domethënës në mjedis (p.sh., aspektet domethënëse mjedisore) Organizata duhet të dokumentojë këtë informacion dhe ta mbajë atë të përditësuar. Organizata duhet të sigurojë që aspektet domethënëse mjedisore, janë marrë në konsideratë në krijimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të saj të menaxhimit mjedisor. A.3.2 Kërkesat ligjore dhe të tjera Organizata duhet të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një procedurë (procedurat): a) për të identifikuar dhe për të pasur akses në kërkesat e zbatueshme ligjore e në kërkesat e tjera për të cilat merr përsipër në lidhje me aspektet e saj mjedisore; dhe b) për të përcaktuar se si zbatohen këto kërkesa në aspeketet e saj mjedisore. Organizata duhet të sigurojë që këto kërkesa të zbatueshme ligjore dhe kërkesat e tjera për të cilat organizata ka marrë përsipër, janë marrë në konsideratë gjatë krijimit, zbatimit dhe mirëmbajtjes të sistemit të saj të menaxhimit mjedisor. A.3.3 Objektiva, synimet dhe programi/ programet Organizata duhet të krijojë, të zbatojë dhe të mirëmbajë objektiva dhe synime mjedisore të dokumentuara, në funksionet dhe nivelet përkatëse brenda organizatës. Objektivat dhe synimet duhet të jenë të matshme, kur është e mundur, dhe në përputhshmëri me politikën mjedisore, duke përfshirë angazhimet për parandalimin e ndotjes, në përputhshmërinë me kërkesat e zbatueshme ligjore dhe me kërkesa të tjera të cilat organizata ka marrë përsipër dhe për përmirësim të vazhdueshëm. Gjatë krijimit dhe rishikimit të objektivave dhe synimeve të saj, një organizatë duhet të marrë në konsideratë kërkesat ligjore dhe kërkesat e tjera të	zbatohet SEMA duhet të jetë në përputhje me të gjitha kërkesat e SEMA duke përfshirë përmirësim të vazhdueshëm të performancës mjedisore, siç është përcaktuar në pikën 3/b të kreut 1, të këtij vendimi. B.4 Përfshirja punonjësve 1) Organizata duhet të pranojë se përfshirja aktive e punonjësve është një forcë lëvizëse dhe një parakusht për përmirësime të vazhdueshme dhe të suksesshme mjedisore, dhe duke qenë një burim i rëndësishëm në përmirësimin e performancës mjedisore, si dhe metoda e drejtë për të ankoruar në mënyrë të suksesshme menaxhimin mjedisor dhe sistemin e auditimit në organizatë. 2) Termi “pjesëmarrja e punonjësve” përfshin edhe pjesëmarrjen dhe informimin e punonjësve individualë dhe përfaqësuesve të tyre. Si rrjedhojë, duhet të ketë një skemë të pjesëmarrjes së punonjësve në të gjitha nivelet. Organizata duhet të pranojë që angazhimi, përgjegjshmëria dhe mbështetja aktive nga ana e menaxhimit është një parakusht për suksesin e këtyre proceseve. Në këtë kontekst, duhet të theksohet nevoja e reagimit nga menaxhimi tek punonjësit. 3) Përveç këtyre kërkesave, punonjësit do të përfshihen në procesin që synon përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore të organizatës nëpërmjet: a) analizës fillestare mjedisore, analizës së status kuo-së dhe në mbledhjen e verifikimit të informacionit; b) krijimit dhe zbatimit të një sistemi të menaxhimit mjedisor dhe të auditimit, duke përmirësuar performancën mjedisore, c) komiteteve mjedisore për të mbledhur informacion dhe për të siguruar pjesëmarrjen e oficerëve mjedisorë / përfaqësuesve të menaxhimit dhe të punonjësve e përfaqësuesve të tyre; ç) grupeve të përbashkëta të punës për programin e veprimit mjedisor dhe auditimin mjedisor, d) përpunimit të e deklaratave mjedisore. 4) Për këtë qëllim duhet të përdoren format e duhura të pjesëmarrjes, të tilla si sistemi sugjerim-libri ose punë grupi, bazuar në projekt apo në komitetet mjedisore. Organizatat duhet të marrin parasysh praktikat më të mira në fushën ku ata



PJESA A Kërkesat e sistemit të menaxhimit mjedisor sipas EN ISO 14001:2004	PJESA B Çështjet plotësuese që duhet të adresohen nga organizatat që zbatojnë SEMA
cilat organizata ka marrë përsipër dhe aspektet e tyre domethënëse mjedisore. Ajo, gjithashtu, duhet të marrë në konsideratë opsionet e saj teknologjike, kërkesat e saj financiare, operative dhe të biznesit, si dhe pikëpamjet e palëve të interesuara. Organizata duhet të krijojë, zbatojë dhe mirëmbajë një program (programet) për arritjen e objektivave dhe synimeve të saj. Programi/programet duhet të përfshijë/përfshijnë: a) përcaktimin e përgjegjësisë për arritjen e objektivave dhe synimeve në funksionet dhe nivelet përkatëse të organizatës; dhe b) mjetet dhe afatet kohore në të cilat ato duhet të arrihen. A.4 Zbatimi dhe funksionimi A.4.1 Burimet, rolet, përgjegjësitë dhe autoriteti Menaxhimi duhet të sigurojë disponueshmërinë e burimeve thelbësore për të krijuar, zbatuar dhe mirëmbajtur sistemin e menaxhimit mjedisor. Burimet përfshijnë burimet njerëzore dhe aftësi të specializuara, infrastrukturë organizative, burime financiare dhe teknologjike. Rolet, përgjegjësitë dhe autoritetet duhet të përkufizohen, dokumentohen dhe komunikohen në mënyrë që të lehtësohet menaxhimi efektiv mjedisor. Menaxhimi i nivelit më të lartë duhet të emërojë përfaqësues menaxhimi specifik, të cilët, pavarësisht përgjegjësisë të tyre, duhet të kenë role, përgjegjësi dhe autoritet të përcaktuar për: a) të sigurojnë që sistemi menaxhimit mjedisor është krijuar, zbatuar dhe mirëmbajtur në përputhje me kërkesat e këtij standardi ndërkombëtar. b) t'i raportuar menaxhimit të nivelit më të lartë për performancën e sistemit të menaxhimit mjedisor, duke përfshirë rekomandimet për përmirësim. A.4.2 Komeptenca, trajnimi dhe ndërgjegjësimi Organizata duhet të sigurojë që çdo person/personat që kryejnë detyra për të ose në emër të saj, që kanë një potencial për të shkaktuar ndikim/e domethënëse mjedisor/e të identifikuar nga organizata, është/janë kompetent/ë në bazë të edukimit, trajnimit ose eksperiencës së duhur dhe duhet të mbajë/në të dhëna shoqëruese. Organizata do të identifikojë nevojat e trajnimit që lidhen me aspektet mjedisore dhe sistemin e saj të menaxhimit mjedisor. Ajo do të sigurojë trajnim	kërkojnë dhe ku duhet, gjithashtu, të përfshihet çdo përfaqësues i punonjësve. B.5 Komunikimi 1) Organizatat duhet të jenë në gjendje të vërtetojnë një dialog të hapur me publikun dhe palët e tjera të interesuara, duke përfshirë komunitetet lokale dhe klientët, në lidhje me ndikimin mjedisor të aktiviteteve, produkteve dhe shërbimeve të tyre, për të identifikuar shqetësimet e publikut dhe palëve të interesuara. 2) Sinqeriteti, transparenca dhe dhënia periodike e informacionit mjedisor janë faktorët kryesorë në diferencimin e SEMA-s nga skemat e tjera. Këta faktorë janë, gjithashtu, të rëndësishëm për organizimin në ndërtimin e besimit me palët e interesuara. 3) SEMA ofron fleksibilitet për të lejuar organizatat që të synojnë informacionin e duhur për audiencat të veçanta, duke siguruar që i gjithë informacioni është në dispozicion për ata që e kërkojnë atë.



PJESA A Kërkesat e sistemit të menaxhimit mjedisor sipas EN ISO 14001:2004	PJESA B Çështjet plotësuese që duhet të adresohen nga organizatat që zbatojnë SEMA
ose të marrë masa të tjera për të përmbushur këto nevoja dhe do të mbajë të dhëna lidhur me to. Organizata do të krijojë, të zbatojë dhe të mbajë një procedurë/procedura për të bërë personat që punojnë për atë apo në emër të saj të vetëdijshëm për: a) rëndësinë e konformitetit me politikën dhe procedurat mjedisore dhe me kërkesat e sistemit të menaxhimit mjedisor; b) aspektet të rëndësishme mjedisore dhe ndikimet aktuale apo të mundshme që lidhen me punën e tyre, si dhe përfitimet mjedisore me përmirësimin e performancës personale; c) rolet dhe përgjegjësitë e tyre në arritjen e përputhshmërisë me kërkesat e sistemit të menaxhimit mjedisor; dhe ç) pasojat e mundshme të largimit nga procedurat e specifikuara. A.4.3 Komunikimi Në lidhje me aspektet mjedisore dhe të sistemit të menaxhimit mjedisor, organizata do të krijojë, zbatojë e mbajë një procedurë/procedura për: a) komunikim të brendshëm ndërmjet niveleve dhe funksioneve të ndryshme të organizatës; b) marrjen, dokumentimin dhe duke iu përgjigjur komunikimit përkatës nga palët e jashtme të interesuara. Organizata do të vendosë nëse do të komunikojë me jashtë për aspektet e saj të rëndësishme mjedisore dhe do të dokumentojë vendimin e saj. Nëse vendimi është për të komunikuar, organizata do të krijojë dhe zbatojë një metodë/metoda për këtë komunikim të jashtëm. A.4.4 Dokumentacioni Dokumentacioni i sistemit të menaxhimit mjedisor duhet të përfshijë: a) politikat, objektivat dhe synimet mjedisore; b) përshkrimin e qëllimit/fushëveprimit të sistemit të menaxhimit mjedisor; c) përshkrimin e elementeve kryesore të sistemit të menaxhimit mjedisor dhe ndërveprimin e tyre dhe duke iu referuar dokumenteve në lidhje me to; ç) dokumentet, duke përfshirë të dhënat që kërkojnë nga ky standard ndërkombëtar; dhe d) dokumentet, duke përfshirë të dhënat e përcaktuara nga organizata, që janë të nevojshme për të siguruar planifikimin, funksionimin dhe	



PJESA A Kërkesat e sistemit të menaxhimit mjedisor sipas EN ISO 14001:2004	PJESA B Çështjet plotësuese që duhet të adresohen nga organizatat që zbatojnë SEMA
kontrollin e proceseve efektive që kanë të bëjnë me aspektet e saj mjedisore të rëndësishme. A.4.5 Kontrolli i dokumenteve Dokumentet e kërkuara nga sistemi i menaxhimit mjedisor dhe nga ky standard ndërkombëtar do të kontrollohen. Të dhënat/rekordet janë një lloj i veçantë i dokumentit dhe do të kontrollohen në përputhje me kërkesat e dhëna në pikën A.4.5. Organizata do të krijojë, zbatojë dhe mbajë një procedurë/procedura me qëllim që: a) të miratojë, para çështjes, dokumentet për mjaftueshmëri; b) të shqyrtojë e të përditësojë, kur të jetë e nevojshme, dhe të rimiratojë dokumente; c) të sigurojë që janë identifikuar ndryshimet dhe statusi aktual i rishikuar i dokumenteve; ç) të sigurojë që versionet përkatëse të dokumenteve të zbatueshme janë në dispozicion në pikat e përdorimit; d) të sigurojë që dokumentet të mbeten të lexueshme dhe lehtësisht të identifikueshme; - dh) të sigurojë që dokumentet me origjinë të jashtme, të përcaktuara nga organizata që janë të nevojshme për planifikimin dhe operimin e sistemit të menaxhimit mjedisor janë identifikuar dhe shpërndarja e tyre është e kontrolluar; e) të parandalojë përdorimin e paqëllimshëm të dokumenteve të vjetruara dhe të aplikojë identifikim të përshtatshëm për to në qoftë se ato mbahen për ndonjë qëllim. A.4.6 Kontrolli operacional Organizata duhet të identifikojë dhe të planifikojë ato operacione që janë të lidhura me aspektet mjedisore të identifikuar të rëndësishme, në përputhje me politikat, objektivat dhe synimet mjedisore të saj, për të siguruar që ato janë kryer nën kushte të veçanta, a) duke krijuar, zbatuar dhe ruajtur një procedurë / procedurë të dokumentuar / dokumentuara për të kontrolluar situatat ku mungesa e tyre mund të çojë në devijim nga politikat, objektivat dhe synimet mjedisore; b) duke përcaktuar kriteret operative në procedurë / procedurë; dhe c) duke krijuar, zbatuar dhe ruajtur procedurat që lidhen me aspektet mjedisore të identifikuar të rëndësishme të mallrave dhe shërbimeve të	



PJESA A Kërkesat e sistemit të menaxhimit mjedisor sipas EN ISO 14001:2004	PJESA B Çështjet plotësuese që duhet të adresohen nga organizatat që zbatojnë SEMA
përdorura nga organizata dhe duke komunikuar procedurat dhe kërkesat e zbatueshme ndaj furnizuesve, përfshirë edhe kontraktorët. A.4.7. Gatishmëria dhe përgjigjet ndaj emergjencave Organizata do të krijojë, do të zbatojë dhe do të mbajë një procedurë/procedura për të identifikuar situata të mundshme emergjente dhe aksidentet e mundshme që mund të ndikojnë mbi mjedisin dhe se si ajo do të reagojë ndaj tyre. Organizata do t'u përgjigjet situatave aktuale emergjente e aksidenteve dhe do të parandalojë ose zbutë ndikimet negative mjedisore të lidhura me to. Organizata do të rishikojë në mënyrë periodike dhe, kur është e nevojshme, të rishikojë procedurat e saj të gatishmërisë e të përgjigjeve ndaj emergjencave, veçanërisht, pasi kanë ndodhur aksidentet ose situatat emergjente. Organizata, gjithashtu, ku është praktike, do të testojë në mënyrë periodike këto procedura. A.5. Kontrolli A.5.1. Monitorimi dhe matja Organizata do të krijojë, zbatojë dhe do të mbajë një procedurë/procedura për të monitoruar e matur, në mënyrë të rregullt, karakteristikat kryesore të operacioneve të saj, që mund të kenë një ndikim të rëndësishëm mjedisor. Procedura/procedurat do të përfshijnë dokumentimin e informacionit për të monitoruar performancën, kontrole operative të zbatueshme dhe konformitetin me objektivat dhe synimet mjedisore të organizatës. Organizata do të sigurojë që përdoren dhe mirëmbahen pajisjet e kalibruara ose të verifikuara të monitorimit e të matjes, dhe do të mbajë të dhëna në lidhje me to. A.5.2. Vlerësimi i përputhshmërisë A.5.2.1. Në përputhje me angazhimin e saj për përputhshmëri, organizata do të krijojë, zbatojë dhe mbajë një procedurë për të vlerësuar periodikisht përputhshmërinë me kërkesat ligjore në fuqi. Organizata do të mbajë të dhëna mbi rezultatet e vlerësimeve periodike. A.5.2.2. Organizata do të vlerësojë përmbushjen e kërkesave të tjera të cilat i ka marrë përsipër. Organizata mund të dëshirojë të kombinojë këtë	



PJESA A Kërkesat e sistemit të menaxhimit mjedisor sipas EN ISO 14001:2004	PJESA B Çështjet plotësuese që duhet të adresohen nga organizatat që zbatojnë SEMA
vlerësim me vlerësimin e përputhshmërisë ligjore të referuar në pikën A.5.2.1 ose të vendosë një procedurë/procedura të veçantë/ veçanta. Organizata do të mbajë të dhëna për rezultatet e vlerësimeve periodike. A.5.3. Moskonformiteti, veprimet korrigjuese dhe veprimet parandaluese Organizata do të krijojë, zbatojë dhe do të mbajë një procedurë/procedura për t'u marrë me mospërputhshmërinë aktuale e potenciale dhe për marrjen e masave korrigjuese e parandaluese. Procedura/ procedurat do të përcaktojë /përcaktojnë kërkesat për: a) identifikimin dhe korrigjimin e mospërputhshmërisë / mospërputhshmërive dhe marrjen e masave për të zbutur ndikimet e tyre mjedisore; b) hetimin e mospërputhshmërisë /mospërputhshmërive, përcaktimin shkaktues /shkaqeve të tyre dhe marrjen e masave për të shmangur përsëritjen e tyre; c) të vlerësuar nevojën për veprim / veprime për të parandaluar mospërputhshmërinë / mospërputhshmëritë dhe zbatimin e masave të duhura të hartuara për të shmangur shfaqjen e tyre; ç) regjistrimin e rezultateve të masave korrigjuese dhe parandaluese të ndërmarra; d) rishikimin e efektivitetit të masave korrigjuese dhe veprimeve parandaluese të ndërmarra. Veprimet e ndërmarra do të jenë të përshtatshme për madhësinë e problemeve dhe ndikimin mjedisor të hasur. Organizata do të sigurojë që është bërë çdo ndryshim i nevojshëm në dokumentacionin e sistemit të menaxhimit mjedisor. A.5.4. Kontrolli i të dhënave Organizata do të krijojë dhe do të mbajë të dhënat që janë të nevojshme për të vërtetuar përputhshmërinë me kërkesat e sistemit të saj të menaxhimit mjedisor e të këtij standardi ndërkombëtar, si dhe rezultatet e arritura. Organizata do të krijojë, zbatojë dhe do të mbajë një procedurë/procedura për identifikimin, ruajtjen, mbrojtjen, rekuperimin, mbajtjen dhe asgjësimin e të dhënave. Të dhënat do të jenë dhe do të mbeten të lexueshme, të identifikueshme dhe të	



PJESA A Kërkesat e sistemit të menaxhimit mjedisor sipas EN ISO 14001:2004	PJESA B Çështjet plotësuese që duhet të adresohen nga organizatat që zbatojnë SEMA
gjurmueshme. A.5.5. Auditimi i brendshëm Organizata do të sigurojë që auditimet e brendshme të sistemit të menaxhimit të mjedisit janë kryer në intervale të planifikuara: a) për të përcaktuar nëse sistemi i menaxhimit mjedisor: - është në përputhje me marrëveshjet e planifikuara për menaxhimin mjedisor, duke përfshirë kërkesat e këtij standardi ndërkombëtar, dhe - është zbatuar siç duhet dhe është ruajtur; dhe b) për të ofruar informacion për rezultatet e auditimeve të menaxhimit. Programi/programet i auditimit duhet të planifikohet, krijohet, implementohet dhe mirëmbahet nga organizata, duke marrë parasysh rëndësinë mjedisore të operacionit/operacioneve në fjalë dhe rezultatet e auditimeve të mëparshme. Procedura e auditimit do të krijohet, implementohet dhe mirëmbahet në një mënyrë që adreson: - përgjegjësitë dhe kërkesat për planifikimin dhe kryerjen e auditimeve, raportimin e rezultateve e mbajtjen e të dhënave në lidhje me to, - përcaktimin e kriterëve të auditimit, fushëveprimin, shpeshtësinë dhe metodat. Përzgjedhja e audituesve dhe kryerja e auditimeve siguron objektivitetin dhe paanshmërinë e procesit të auditimit. A.6. Analiza/rishikimi i menaxhimit Menaxhimi i nivelit më të lartë do të rishikojë sistemin e menaxhimit mjedisor të organizatës, në intervale të planifikuara, për të siguruar përshtatshmërinë, majftueshmërinë dhe efektivitetin e tij të vazhdueshëm. Rishikimet duhet të përfshijë vlerësimin e mundësive për përmirësim dhe nevojën për ndryshime në sistemin e menaxhimit mjedisor, duke përfshirë politikën mjedisore dhe objektivat e synimet mjedisore. Duhet të mbahen të dhënat e rishikimeve të menaxhimit. Të dhënat e rishikimeve të menaxhimit do të përfshijnë: a) rezultatet e auditimeve të brendshme dhe vlerësimet e përputhshmërisë me kërkesat ligjore e me kërkesat e tjera të cilat organizata ka marrë	



PJESA A Kërkesat e sistemit të menaxhimit mjedisor sipas EN ISO 14001:2004	PJESA B Çështjet plotësuese që duhet të adresohen nga organizatat që zbatojnë SEMA
përsipër; b) komunikimi/komunikimet nga palët e jashtme të interesuara, duke përfshirë ankesat; c) performancën mjedisore të organizatës; ç) masën në të cilën janë përmbushur objektivat dhe synimet; d) statusin e masave korrigjuese dhe parandaluese; dh) veprimet pasuese nga rishikimet e mëparshme të menaxhimit; e) rrethanat në ndryshim, duke përfshirë edhe zhvillimet në kërkesat ligjore e të tjera të lidhura me aspektet mjedisore; dhe ë) rekomandimet për përmirësim. Rezultatet nga rishikimet e menaxhimit duhet të përfshijnë të gjitha vendimet dhe veprimet që lidhen me ndryshimet e mundshme në politikat, objektivat dhe synimet mjedisore, si dhe elemente të tjera të sistemit të menaxhimit mjedisor, në përputhje me angazhimin për përmirësim të vazhdueshëm.	

SHTOJCA III

AUDITIMI MJEDISOR I BRENDSHËM

A. Programi auditimit dhe frekuenca e auditimit

1. Programi i auditimit

Programi i auditimit duhet të garantojë që menaxhimi i organizatës është i pajisur me informacionin e nevojshëm që i duhet për të analizuar performancën mjedisore të organizatës dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit mjedisor, si dhe të jetë në gjendje për të vërtetuar që ato janë nën kontroll.

2. Objektivat e programit të auditimit

Objektivat, në veçanti, duhet të përfshijnë vlerësimin e sistemeve operative të menaxhimit dhe të përcaktojnë konformitetin me politikën e programin e organizatës, e cila duhet të ketë përputhshmëri me kërkesat mjedisore rregullatore përkatëse.

3. Qëllimi i programi të auditimit

Qëllimi i përgjithshëm i auditimeve individuale, ose të secilës fazë të ciklit të auditimeve, kur është e përshtatshme, duhet të jetë i përcaktuar qartë dhe duhet të specifikojë:

- fushat e temave të mbuluara;
- aktivitetet që do të auditohen;

c) kriteret mjedisore që do merren në konsideratë;

d) periudhën e mbuluar nga auditimi.

Auditimi mjedisor përfshin vlerësimin e të dhënave faktike të nevojshme për të vlerësuar performancën mjedisore.

4. Frekuenca e auditimit

Auditimi ose cikli i auditimit, i cili mbulon të gjitha aktivitetet e organizatës, duhet të përfundojë, si të jetë e përshtatshme, në intervale jo më të gjata se tre vjet ose katër vjet, nëse zbatohet përjashtimi sipas përcaktimeve në pikën 5 të Kreut III të këtij vendimi. Frekuenca me të cilën varion çdo auditim varet në:

a) natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktivitetëve;

b) rëndësinë e ndikimeve mjedisore të shoqëruara;

c) rëndësinë dhe emergjencën e problemeve të zbuluara nga auditimet e mëparshme;

ç) historinë e problemeve mjedisore.

Aktivitetet më komplekse me një ndikim mjedisor më domethënës duhet të auditohen më shpesh.

Organizata duhet të kryejë auditime të paktën çdo vit, pasi kjo do të ndihmojë që t'i vërtetojë



menaxhimit të organizatës dhe verifikuesit mjedisor që ajo është në kontroll për aspektet domethënëse mjedisore.

Organizata duhet të kryejë auditime në lidhje me:

- a) performancën mjedisore të organizatës; dhe
- b) përputhshmërinë e organizatës me detyrimet e zbatueshme ligjore në lidhje me mjedisin.

B. Aktivitetet e auditimit

Aktivitetet e auditimit duhet të përfshijnë diskutimet me personelin, inspektimin e kushteve të punës e të pajisjeve dhe rishikimin e të dhënave, procedurave të shkruara dhe çdo dokumentacion tjetër përkatës me objektivin e vlerësimit të performancës mjedisore të aktivitetit që është duke u audituar, për të përcaktuar nëse ai i përmbush standardet dhe rregullat e zbatueshme ose objektivat dhe synimet mjedisore të përcaktuara, dhe nëse sistemi që funksionon aktualisht për të menaxhuar përgjegjësitë është efektiv dhe i duhuri. Ndër të tjera, duhet të përdoren kontrole të paparalajmëruara për përputhshmërinë me këto kritere, për të përcaktuar efektivitetin e të gjithë sistemit të menaxhimit.

Në veçanti, në procesin e auditimit duhet të përfshihen, hapat e mëposhtme:

- a) të kuptuarit e sistemeve të menaxhimit;
- b) vlerësimi i pikave të forta dhe të dobëta të sistemeve të menaxhimit;
- c) mbledhja e evidencave përkatëse;
- ç) vlerësimi i gjetjeve të auditimit;
- d) përgatitja e konkluzioneve të auditimit;
- dh) raportimi i gjetjeve dhe konkluzioneve të auditimit.

C. Raportimi i gjetjeve dhe konkluzioneve të auditimit

Objektivat thelbësore të një auditimi të shkruar janë:

- a) të dokumentohet qëllimi i auditimit;
- b) t'i ofrojë menaxhimit informacion për gjendjen e përputhshmërisë me politikën mjedisore të organizatës dhe progresin mjedisor të organizatës;
- c) t'i ofrojë menaxhimit informacion për efektivitetin dhe besueshmërinë e planifikimeve për monitorimin e ndikimeve mjedisore të organizatës;
- ç) të vërtetojë nevojën për veprime korrigjuese, kur është e përshtatshme.

SHTOJCA IV RAPORTIMI MJEDISOR

A. Hyrje

Informacioni mjedisor duhet të paraqitet në një mënyrë të qartë dhe koherente në format elektronik ose në format të printuar.

B. Deklarata mjedisore

Deklarata mjedisore duhet të përmbajë të paktën elementet dhe duhet të plotësojë kërkesat minimale të përcaktuara më poshtë:

a) Një përshkrim të pastër dhe të qartë të organizatës që po regjistrohet në SEMA dhe një përmbledhje të aktiviteteve të saj;

b) Politikën mjedisore dhe një përshkrim të shkurtër të sistemit të menaxhimit mjedisor të organizatës;

c) Një përshkrim të të gjitha aspekteve të rëndësishme të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të cilat rezultojnë në ndikime të rëndësishme mjedisore të organizatës dhe një shpjegim të natyrës së ndikimeve që lidhen me këto aspekte (shtojca I, pika 2);

ç) Një përshkrim të objektivave dhe synimeve mjedisore në lidhje me aspektet dhe ndikimet e rëndësishme mjedisore;

d) Një përmbledhje të të dhënave të disponueshme për performancën e organizatës kundrejt objektivave dhe synimeve të saj mjedisore në lidhje me ndikimet e rëndësishme mjedisore të tyre. Raportimi duhet të jetë për indikatorët kryesorë dhe për indikatorë mjedisorë të tjerë përkatës ekzistues, siç janë përcaktuar në seksionin C;

dh) faktorë të tjerë në lidhje me performancën mjedisore, duke përfshirë performancën kundrejt dispozitave ligjore në lidhje me ndikimet e tyre mjedisore domethënëse;

e) një referencë ndaj kërkesave të zbatueshme ligjore në lidhje me mjedisin;

ë) emrin dhe numrin e akreditimit ose licencimit të verifikuesit mjedisor dhe të dhënat e vlefshmërisë.

Deklarata mjedisore e përditësuar duhet të përmbajë, të paktën, elementet dhe duhet të përmbushë kërkesat minimale të përcaktuara në shkronjat “e” deri në “h”.

C. Indikatorët kryesorë dhe indikatorë të tjerë përkatës të performancës mjedisore ekzistues



1. Hyrje

Organizatave duhet të raportojnë, edhe në deklaraten mjedisore edhe në deklaraten mjedisore të përditësuar, për indikatorët kryesorë deri më tani, pasi këto kanë lidhje me aspektet mjedisore të drejtpërdrejta të organizatës dhe indikatorë të tjerë përkatës ekzistues të performancës mjedisore, siç janë përcaktuar më poshtë:

Raportimi duhet të ofrojë të dhëna për inputin/ndikimin aktual. Nëse zbulimi do të ndikojë negativisht në konfidencialitetin e informacionit tregtar ose industrial të organizatës, kur një konfidencialitet i tillë parashikohet nga legjislacioni në fuqi për të mbrojtur një interes legjitim të organizatës, organizatës mund t'i lejohej të pajisë me një indeks këtë informacion në raportimin e saj, p.sh., duke krijuar një vit linje bazë (me numrin e indeksit 100), nga i cili do të shfaqet inputi/ndikimi aktual.

Indikatorët duhet:

a) të japin një vlerësim të saktë të performancës mjedisore të organizatës;

b) të jenë të kuptueshëm dhe të qartë;

c) të lejojnë një krahasim nga viti në vit për të vlerësuar zhvillimin e performancës mjedisore të organizatës;

ç) të lejojnë për krahasim me standardet sektoriale, kombëtare ose rajonale, si të jetë e përshtatshme;

d) të lejojnë për krahasim me kërkesat rregullatore, si të jetë e përshtatshme.

2. Indikatorët kryesorë

Indikatorët kryesorë duhet të zbatohen për të gjitha llojet e organizatave. Ato përqendrohen në performancën e fushave kryesore mjedisore të mëposhtme:

i) efikasitetin e energjisë;

ii) efikasitetin e materialit;

iii) ujin;

iv) mbeturinat;

v) biodiversitetin;

vi) emetimet.

Kur një organizatë arrin në përfundimin se një apo më shumë nga indikatorët kryesorë nuk janë të rëndësishëm për aspektet e saj mjedisore domethënëse të drejtpërdrejta, ajo mund të mos raportojë për ata indikatorë kryesorë. Organizata ofron arsyetime për këtë qëllim, duke u referuar në analizën e saj mjedisore.

b) Çdo indikator kryesor është i përbërë nga:

i) një figurë A, që tregon inputin/ndikimin total vjetor në një fushë të caktuar;

ii) një figurë B, që tregon prodhimin/output e përgjithshëm vjetor të organizatës; dhe

iii) një figurë R, që tregon raportin A/B.

Çdo organizatë duhet të raportojë për çdo indikator të secilit nga tre elementet.

c) Tregimi i inputit/ndikimit total vjetor në një fushë të caktuar, figura A, duhet të raportohet si më poshtë:

i) Për efikasitetin e energjisë:

- në lidhje me “energjinë e drejtpërdrejtë totale të përdorur”, konsumin total të energjisë vjetore, të shprehur më MWh;

- në lidhje me “energjinë e rinovueshme totale të përdorur”, përqindjen e konsumit vjetor total të energjisë (elektricitet dhe nxehtësi) të prodhuar nga organizata nga burimet e energjisë së rinovueshme.

ii) Për efikasitetin e materialit:

- në lidhje me “fluksin e masës vjetore të materialeve të ndryshme të përdorura” (duke përfshirë transportuesit e energjisë dhe ujin) të shprehur në ton.

iii) Për ujin:

- në lidhje me “konsumin e ujit vjetor total”, të shprehur në m³.

iv) Për mbeturinat:

- në lidhje me “gjenerimin total vjetor të mbetjeve”, të ndara në lloje, të shprehur në ton;

- në lidhje me “gjenerimin e mbetjeve të rrezikshme totale vjetore”, të shprehur në kilogram ose ton.

v) Për biodiversitetin:

- në lidhje me “përdorimin e tokës”, e shprehur në m² në zonat e ndërtuara.

vi) Për emetimet:

- në lidhje me “emetimet totale vjetore të gazeve të efektit serrë”, duke përfshirë të paktën emetimet e CO₂, CH₄, N₂O, HFCs, PFCs and SF₆, të shprehur në ton të CO₂ ekuivalente;

- në lidhje me “emetimet totale vjetore në ajër”, duke përfshirë të paktën SO₂, NO_x dhe PM, të shprehur në kilogram ose ton.

Përveç indikatorëve të përcaktuar më lart, një organizatë mund të përdorë, gjithashtu, indikatorë të tjerë për të shprehur inputin/ndikimin total vjetor në një fushë të caktuar.

ç) Paraqitja e prodhimit/output të përgjithshëm total vjetor të organizatës, figura B, është e njëjtë

për të gjitha fushat, por është miratuar për lloje të ndryshme organizatash, në varësi të llojit të aktivitetit të tyre, dhe duhet të raportohet si më poshtë:

i) për organizatat që punojnë në sektorin e prodhimit (industri), duhet të tregojë totalen vjetore bruto të vlerës së shtuar, të shprehur në milion euro (Euro Milion) ose prodhimin fizik total vjetor, të shprehur në ton apo, në rastin e organizatave të vogla, qarkullimin e përgjithshëm vjetor ose numrin e të punësuarve;

ii) për organizatat që nuk janë në sektorin e prodhimit (administrim/shërbime), duhet të lidhet me madhësinë e organizatës, të shprehur në numrin e të punësuarve.

Përveç indikatorëve të përcaktuar më lart, një organizatë mund të përdorë gjithashtu indikatorë të tjerë për të shprehur prodhimin/output total vjetor.

3. Indikatorë të tjerë përkatës të performancës mjedisore

Çdo organizatë duhet të raportojë çdo vit për performancën e saj në lidhje me aspektet specifike mjedisore, siç është identifikuar në deklaratën e saj mjedisore, dhe, kur është e disponueshme, të marrë në konsideratë dokumentet referencë sektoriale.

Ç. Disponueshmëria publike

Organizata duhet të jetë në gjendje t'i vërtetojë verifikuesit mjedisor që çdo personi të interesuar, në performancën mjedisore të organizatës, mund t'i jepet akses lehtësisht dhe lirisht në informacionin e kërkuar më lart, sipas seksioneve "B" dhe "C", të kësaj shtojce.

Organizata do të sigurojë që ky informacion të jetë në dispozicion në gjuhët shqip dhe anglisht.

SHTOJCA V LOGOJA SEMA



1. Logoja mund të përdoret duke përmbajtur tekstin e mëposhtëm, në gjuhët shqip dhe anglisht, përkatësisht:



Shqip “Menaxhim mjedisor i verifikuar”;
 Anglisht “Verified environmental management”.

3. Logoja duhet të përdoret ose:

- në tri ngjyra (Pantone nr.355, jeshile; Pantone nr.109, e verdhë; Pantone nr.286, blu);
- në të zezë;
- në të bardhë, ose
- në shkallë gri.

SHTOJCA VI

KËRKESAT E INFORMACIONIT PËR REGJISTRIM (Informacioni të parashikohet kur është i zbatueshëm)

1. ORGANIZATA

Emër
 Adresa
 Qyteti
 Kodi postar
 Qarku/bashkia

 Personi i kontaktit
 Telefon
 FAKS
 E-mail
 Website
 Akses publik në deklaratat mjedisore ose në deklaratat mjedisore të përditësuara
 a) format i printuar
 b) format elektronik
 Numri regjistrimit
 Data e regjistrimit
 Data e pezullimit të regjistrimit
 Data e fshirjes së regjistrimit
 Data e deklaratës së ardhshme mjedisore
 Data e deklaratës së ardhshme mjedisore të përditësuar

Kërkesë për përjashtim në zbatim të pikës 5, të kreut III, të këtij vendimi.

.....
 PO – JO
 Kodi i aktiviteteve NACE
 Numri i të punësuarve
 Qarkullimi ose bilanci vjetor

2. VENDNODHJA

Emër
 Adresa
 Kodi postar



Qyteti
 Qarku/bashkia

 Personi i kontaktit
 Telefon
 FAKS
 E-mail
 Website
 Akses publik në deklaratat mjedisore ose në deklaratat mjedisore të përditësuar
 a) format i printuar
 b) format elektronik
 Numri i regjistrimit
 Data e regjistrimit
 Data e pezullimit të regjistrimit
 Data e fshirjes së regjistrimit
 Data e deklaratës së ardhshme mjedisore
 Data e deklaratës së ardhshme mjedisore të përditësuar
 Kërkesë për përjashtim në zbatim të të pikës 5, të kreut III, të këtij vendimi
 PO – JO
 Kodi i aktiviteteve NAÇE
 Numri i të punësuarve
 Qarkullimi / ose bilanci vjetor

3. VERIFIKUESI MJEDISOR

Emri verifikuesit mjedisor
 Adresa
 Kodi postar
 Qyteti
 Qarku/bashkia

 Personi i kontaktit
 Telefon
 FAKS
 E-mail
 Numri i regjistrimit të akreditimit ose licencimit
 Fushëveprimi i akreditimit (kodet NAÇE)

 Organizmi i akreditimit

 Bërë në..... më...../...../20
 Nënshkrimi i përfaqësuesve të organizatës



SHTOJCA VII

DEKLARATA E VERIFIKUESIT MJEDISOR PËR AKTIVITETET E VERIFIKIMIT DHE VLEFESHMËRISË

..... (emri).

me numër regjistrimi të verifikuesit mjedisor SEMA

akredituar ose licencuar për qëllimin (kodi NACE)

deklaron që ka verifikuar vendndodhjen/vendndodhjet ose të gjithë organizatën, siç tregohet në deklaratën mjedisore/deklaratën mjedisore të përditësuar(*) të organizatës (emri)

me një numër regjistrimi (nëse është i disponueshëm)

përmbush të gjitha kërkesat e këtij vendimi.

Duke nënshkruar këtë deklaratë, Unë deklaroj që:

- verifikimi dhe vlefshmëria është kryer në përputhshmëri të plotë me kërkesat e këtij vendimi;
- rezultatet e verifikimit dhe vlefshmërisë konfirmojë që nuk ka asnjë evidencë të mospërputhshmërisë me kërkesat e zbatueshme ligjore në lidhje me mjedisin;
- të dhënat dhe informacioni i deklaratës mjedisore / deklaratës mjedisore të përditësuar(*) të organizatës reflektojnë një imazh të besueshëm, të saktë dhe të sigurt të të gjitha aktiviteteve të organizatës/vendndodhjeve(*), brenda fushëveprimit të përmendur në deklaratën mjedisore.

Ky dokument nuk është ekuivalent me regjistrimin në SEMA. Regjistrimi në SEMA mund të jepet vetëm nga organi kompetent, sipas kërkesave dhe përcaktimeve të këtij vendimi.

Ky dokument nuk duhet të përdoret si material më vete për komunikimet publike.

Bërë në më / ... / 20

Nënshkrimi

(*) kaloje kur nuk është e zbatueshme

**KËRKESË****Nr. 3980, datë 20.7.2015****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i realizimit të projektit "Ndërtimi i linjës së re të ujësjellësit të Durrësit", në zonën e Adriatikut, të Fushë-Milotit dhe të Durrësit. Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizime. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar, për pronarët emërorë sipas listës bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i

këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Ky publikim bëhet vetëm për pasurinë e llojit "tokë bujqësore".

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-Kanalizimeve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik".

Vlera totale e shpronësimit është 1 312 500 (një milion e treqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

Tabele: Lista e Pronareve qe do te shpronsohen nga ndertimi i Ujesjellesit (Vend burimi Fushe Milot)

Nr	Komuna / Fshati	Emertimi i Pusit	Emer Mbiemer i Pronarit	Nr. I parcelës	Nr. Kadastrës	Nr. Pronarve	Statusi Ligjor i Pronësisë	Tipi i Tokës	Sipërfaqe totale (m2)	Vlerësimi i Sipërfaqes për Shpronësim (m2)			
										Sipërfaqe qe shpronësohet (m2)	Cmim (ALL/ m2)	Vlera e Shpronësimit (ALL)	Statusi Ligjor në ZRPP
1	Komuna Milot / Fshati Fushe Milot	FM - 1	Kol Marku (Frrok Marku dhe Danjel Marku sipas ligjit 7501)	35/27	1677	1	Pa regjistruar	Tokë Bujqësore	1400	625	350	218 750	Pa Regjistruar
2	Komuna Milot / Fshati Fushe Milot	FM - A	Ndue Lazer Mehilli	40/14	2580	1	Ne proces	Tokë Bujqësore	6700	625	350	218 750	Ne Proces
3	Komuna Milot / Fshati Fushe Milot	FM - 4	Loro Gjon Kolaj	38/17	1677	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	4000	625	350	218 750	Regjistruar
4	Komuna Milot / Fshati Fushe Milot	FM - B	Ismet Taf Veseli	43/2	1677	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	18000	312.5	350	109 375	Regjistruar
5	Komuna Milot / Fshati Fushe Milot	FM - B	Xhumaile Adbulla Veseli	43/44	1677	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	2016	312.5	350	109 375	Regjistruar
6	Komuna Milot / Fshati Fushe Milot	FM - D	Murat Hasan Veseli	42/26	1677	1	Regjistruar	Tokë Bujqësore	1850	625	350	218 750	Regjistruar
7	Komuna Milot / Fshati Fushe Milot	FM - E	Dervish Zenel Haxhiu (Te bijte: Alush Haxhiu, Kujtim Haxhiu sipas ligjit 7501)	43/19	1677	1	Ne proces	Tokë Bujqësore	11100	625	350	218 750	Ne Proces
TOTAL										3750		1 312 500	

**KËRKESË****Nr. 4413/5, datë 15.7.2015****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Energjisë dhe Industrisë shpall kërkesën për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugëve hyrëse dhe urave për zonat: Fier, Skrapar dhe Korçë (pjesë e projektit të gazsjellësit "Trans Adriatik").

Subjekti kërkuar i kësaj kërkesë është "Trans Adriatic Pipeline AG Shqipëri", shoqëri e cila do të zhvillojë një tubacion të gazit natyror, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim, sipas listave emërore bashkëlidhur mbi masën e vlerësimit të llogaritur në zbatim të ligjit të posaçëm nr. 116/2013, datë 15.4.2013, në përputhje me planin e rehabilitimit të jetesës.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në listat emërore të publikuara, si dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit dhe marrjes në përdorim të përkohshëm. Lutemi pronarëve dhe personave që pretendojnë pronësinë mbi pasuritë që preken nga ky projekt, të dorëzojnë çdo dokument që disponojnë pranë ZVRPP-së përkatëse për shënime të bëra nga ZVRPP-të në listën bashkëlidhur mbi saktësimin dhe konfirmimin e sipërfaqeve, mungesat e dokumentacionit etj.

MINISTRI I ENERGJISË DHE INDUSTRIËS
Damian Gjijnuri

LISTA E PASURIVE "SHTET" QË PREKEN NGA RRUGËT HYRËSE

Nr.	Pronari/Përdoruesi	ZK.	Nr.Pas.	Lloji Pas.	Sip. m ² për Marrje në Përdorim të Përkohshëm	Vlera Totale e Kulturave	Objekte Vlera Lekë	Vlera Totale Lekë	Indexi Hartës	Shënime
1	Shtet	1752	105/17	Arë	156	30.247,46		30.247,46	K-34-111-(175-D)	Liu Ndoni është përdorues i cili pretendon dhe pronësinë për këtë pasuri, pasi zotëron AMTP.
2	Shtet	1752	104/20	Arë	115	25.066,76		25.066,76	K-34-111-(175-D)	Maksim Llambi Ndoni është përdorues i cili pretendon dhe pronësinë për këtë pasuri, pasi zotëron AMTP. Sipas ZVRPP kjo pasuri është e okupuar nga Maksim Llambi Ndoni
3	Shtet	1752	104/24	Arë	9	130,14		130,14	K-34-111-(175-D)	Llaqi Mine, është përdorues i cili pretendon dhe pronësinë për këtë pasuri, pasi zotëron AMTP. Sipas ZVRPP kjo pasuri është e okupuar nga Llaqi Thoma Mine
4	Shtet	1874	78/8	Arë	102	4.224	99.777	104.001,00	K-34-111-(174-C)	Ndoni Koli Monka është përdorues i cili pretendon dhe pronësinë për këtë pasuri (Objekti është ure)
5	Shtet	3358	40/2	Arë	7	352,74		352,74	K-34-111-(175-D)	Ladi Loshi është përdorues i cili pretendon dhe pronësinë për këtë pasuri, por nuk zotëron dokumenta.
6	Shtet	3358	71/4	Arë	17	3.204		3.204,00	K-34-111-(173-D)	Radosav Rashoviq është përdorues i cili pretendon dhe pronësinë për këtë pasuri. Sipas ZVRPP kjo pasuri është e okupuar nga Radosav Drago Rashoviq
7	Shtet	3358	71/5	Arë	60	18.720		18.720,00	K-34-111-(173-D)	Arian Abazi është përdorues i cili pretendon dhe pronësinë për këtë pasuri. Sipas ZVRPP kjo pasuri është e okupuar nga Arian Pasho Abazi
8	Shtet	3358	72/2	Arë	35	420		420,00	K-34-111-(173-D)	Arian Abazi është përdorues i cili pretendon dhe pronësinë për këtë pasuri. Sipas ZVRPP kjo pasuri është e okupuar nga Arian Pasho Abazi
9	Shtet	3358	34/6	Arë	166	3.154		3.154,00	K-34-111-(175-A)	Kostandin Moni është përdorues i cili pretendon dhe pronësinë për këtë pasuri, pasi zotëron formularin F6. Sipas ZVRPP kjo pasuri është e okupuar nga Konstandin Kozma Moni
10	Shtet	3358	34/5	Arë	489	8.936		8.936,00	K-34-111-(175-A)	Arqile Moni është përdorues i cili pretendon dhe pronësinë për këtë pasuri, pasi zotëron formularin F6. Sipas ZVRPP kjo pasuri është e okupuar nga Arqile Kozma Moni
11	Shtet	3358	34/2	Arë	458	18.936,67		18.936,67	K-34-111-(175-A)	Nikolla Goga është përdorues i kësaj pasurie i cili pretendon dhe pronësinë pasi zotëron formularin F6. Sipas ZVRPP kjo pasuri është e okupuar nga Nikolla Llaz Goga
12	Shtet	3358	250	Arë	1.023	12.276,00		12.276,00	K-34-111-(173-D)	Ramadan Backa është përdorues i cili pretendon pronësinë për këtë pasuri.
13	Shtet	3358	63/2	Arë	1.395	108.140,69		108.140,69	K-34-111-(174-C)	Petra Trfika është përdorues i cili pretendon pronësinë për këtë pasuri.
TOTALI					4.032	233.808,46	99.777,00	333.585,46		


RRETHET FIER, KORÇË, DEVOLL DHE SKRAPAR
LISTA E PRONARËVE, TË CILËT PREKEN NGA RRUETË HYRËSE

Nr.	Pronari			ZK	Nr.Pas	Lloji Pas.	Sip. m ² për Marrje në Përdorim të Përkohshëm Për 2 vjet	Cmimi Lekë/m ²	Vlera Lekë	Sip.m ² Shpronësim	Cmimi Lekë/m ²	Vlera Lekë	Vlera Totale e Kulturave	Objekte Vlera Lekë	Vlera Totale Lekë	Indeksi i Haritës	Shënime
1	Luan	Namik	Shahaj	1414	245/36	Artë				689,00	580,00	399.620,00			399.620	K-34-111-(192-A)	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Nasi	Zogu	Kolici	1752	105/9	Artë	2,00	145,00	290,00		580,00		24,00	97.653,00	97.967	K-34-111-(175-D)	Konfirmuar nga ZVRPP (Objekti është ure me tombina)
3	Altin	Thimi	Shqepa	1752	105/11	Artë	97,00	207,00	20.079,00	33,00	828,00	27.324,00	14.786,20		62.189,20	K-34-111-(175-D)	ZVRPP konfirmim se kjo pasuri është e inkuizuar/ bllokuar
4	Irakli	Kristo	Mine	1752	105/13	Artë	140,00	145,00	20.300,00		580,00		93.725,00		114.025	K-34-111-(175-D)	ZVRPP konfirmim se ndalohen veprimet deri në zgjidhjen e problemit (Ndryshon entri në AMTP me atë në kartelë)
5	Fatmir	Nuan	Voja	1752	105/20	Artë	22,00	62,75	1.380,50		251,00		5.000,00	92.286,00	98.666,50	K-34-111-(175-D)	Konfirmuar nga ZVRPP (Objekti është mur me blloqe betoni dhe tulla)
6	Arqile	Kristo	Mine	1752	99/3	Artë	1.653,00	207,00	342.171,00	1.442,00	828,00	1.193.976,00	84.833,95		1.620.980,95	K-34-111-(175-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Dhimitraq	Trifon	Mine	1752	101/4	Artë + Tnuall				338,00	828,00	279.864,00			279.864	K-34-111-(175-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Nasi	Zogu	Kolici	1752	105/2	Artë	440,00	145,00	63.800,00	20,00	580,00	11.600,00	5.796,00	109.676,00	190.872	K-34-111-(175-D)	Konfirmuar nga ZVRPP (Objekti është ure me tombina)
9	Jorgji	Peti	Peto	3300	3/60	Artë	897,00	105,50	94.633,50	350,00	422,00	147.700,00	14.964,00		257.297,50	K-34-111-(175-A)	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Jorgaj	Nuan	Xhaho	3358	71/6	Artë + Tnuall	43,00	162,25	6.976,75		649,00		73.316,23	38.174,00	118.466,98	K-34-111-(173-D)	Konfirmuar nga ZVRPP (Objekti është dërrë hekur)
11	Lici	Vasil	Kordishata	3612	158/7	Artë	826,00	207,00	170.982,00	964,00	828,00	798.192,00	62.399,40		1.031.573,40	K-34-111-(192-A)	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Harrila	Liko	Kordishata	3612	158/8	Artë	890,00	207,00	184.230,00	591,00	828,00	489.348,00	51.627,66		725.205,66	K-34-111-(191-B)	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Themi	Llazi	Rina	3612	157/33	Artë	359,00	145,00	52.055,00	15,00	580,00	8.700,00	12.312,08		73.067,08	K-34-111-(192-A)	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Vasil	Petra	Shore	3790	219/2	Artë	331,00	129,75	42.947,25				67.397,00		110.344,25	K-34-126-(99-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
TOTALI							5.700,00		999.845,00	4.462,00		3.356.324,00	486.181,52	337.789,00	5.180.139,52		

RRETHET FIER, KORÇË, DEVOLL DHE SKRAPAR
LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA RRUETË HYRËSE ME MINIMUMIN E KOMPENSIMIT

Nr.	Pronari			ZK	Nr.Pas	Lloji Pas.	Sip. m ² për Marrje në Përdorim të Përkohshëm për 2 vjet	Sip.m ² Shpronësim	Vlera Totale e Kulturave	Objekte Vlera në lekë	Vlera Totale Lekë	Indeksi i Haritës	Shënime
1	Aurora	Elmas	Mustafallari	1420	32	Artë	299,00	98,00	6.964,00		56.000,00	K-34-125-(120-D)	I Pakonfirmuar
2	Dylber	Muhamet	Merko	1752	105/1	Artë		27			15.660	K-34-111-(175-D)	ZVRPP konfirmim se ndalohen veprimet mbi pasurinë me afat deri në zgjidhjen e problemit (AMTP është e pafirmosur)
3	Trifon	Thoma	Papaj	1752	105/3	Artë	134		12.323,20		56.000	K-34-111-(175-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Vasil	Xoxi	Papaj	1752	105/6	Artë	102		2.233,80		56.000	K-34-111-(175-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Xoxi	Thoma	Papaj	1752	105/4	Artë	144				56.000	K-34-111-(175-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Dhimitraq	Vasil	Koti	1752	105/7	Artë	263	1	8.690,88		56.000	K-34-111-(175-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Vasil	Xoxi	Koti	1752	105/8	Artë	80			9.099,20	56.000	K-34-111-(175-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Dhimitraq	Vasil	Koti	1752	105/10	Artë	72				56.000	K-34-111-(175-D)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
9	Andon	Gaqi	Kozmai	1752	105/15	Artë	73		20.303,02		56.000	K-34-111-(175-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Kristaq	Stefan	Hena	1752	105/21	Artë	240		1.560		56.000	K-34-111-(175-D)	ZVRPP konfirmim se ndalohen veprimet mbi pasurinë me afat deri në zgjidhjen e problemit (AMTP është e pafirmosur)
11	Maksim	Llambri	Ndoni	1752	104/19	Artë	49	1	5.246		56.000	K-34-111-(175-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Arben	Pali	Shqepa	3300	56/53	Artë	113		1.356		56.000	K-34-111-(175-B)	ZVRPP konfirmim se në AMTP mungon vula e njërit prej institucioneve sipas Udhëzimit 2/2013
13	Liko	Pali	Celniku	3300	3/59	Artë	18		216		56.000	K-34-111-(175-A)	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Pavlina	Pjetri		3358	73/1	Artë	260		3.120		56.000	K-34-111-(173-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
15	Radoshav	Drago	Rashoviq	3358	71/3	Artë	25				56.000	K-34-111-(173-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Artur	Zalo	Cakaj	3358	231/5	Artë	100		1.446		56.000	K-34-111-(173-B)	ZVRPP konfirmim se për këtë pasuri ka vendim sekuestro (Vendimi Nr.19/11, datë 19.11.2013, të Prok. Gjyq. Shk.pare Fier)
17	Margarita	Miti	Cako	3358	4/1	Artë	159		1.902		56.000	K-34-111-(157-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
18	Maliq	Rrapo	Xheladini	1949	129/7	Artë		62,00			13.206,00	K-34-125-(142-C)	Për Rikonfirmim pranë ZVRPP
19	Novruz	Brauhaj							1.488,00		1.488,00	K-34-125-(142-C)	Përdoruesi likuidohet vetëm për kulturat
20	Petitri	Rrapo	Braho	3037	7/32	Artë	2,00		24,00		56.000,00	K-34-125-(139-B)	Konfirmuar nga ZVRPP
21	Hajdar	Skender	Zaimi	3596	248/21	Tnuall	5,00		3.897,60		56.000,00	K-34-125-(101-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
22	Krenar	Hajdar	Zaimi	3596	248/20	Tnuall		16,00	21.987,10		56.000,00	K-34-125-(101-C)	I Pakonfirmuar
23	Neim	Kajmak	Zaimi	3596	248/22	Tnuall		8,00	96,00		56.000,00	K-34-125-(101-C)	I Pakonfirmuar
24	Lyfll	Mete	Cuedari	3596	217/53	Tnuall		2,00	24,00		56.000,00	K-34-125-(100-C)	I Pakonfirmuar
25	Altin	Haziz	Cuedari	3596	217/118	Artë	68,00	19,00	4.851,50		56.000,00	K-34-125-(101-C)	Për Rikonfirmim pranë ZVRPP
26	Pelumb	Muhamet	Dervishi	3596	217/29	Artë	270,00	28,00	25.138,50		56.000,00	K-34-125-(101-C)	Për Rikonfirmim pranë ZVRPP
27	Piro	Thoma	Shore	3790	240/3	Artë	27,00		324,00		56.000,00	K-34-126-(99-D)	Konfirmuar nga ZVRPP
28	Llambro	Sabri	Qirushi	3946	76/9	Artë	2,00		24,00		56.000,00	K-34-125-(137-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
29	Zaim	Sabri	Hysa	3946	76/12	Artë	18,00		216,00		56.000,00	K-34-125-(137-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
30	Medi	Jahja	Ismaili	3946	76/3	Artë	24,00		288,00		56.000,00	K-34-125-(137-C)	Konfirmuar nga ZVRPP
TOTALI							2.547,00	262,00	132.818,80	0,00	1.551.453,20		

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 252 lekë